

# KOSOVIA RJA

## JETLIRA ZYFI

la Zvicrën për të ngritur  
“Medical Hills”,  
perandorinë e estetikës  
dhe bukurisë në Shqipëri





# CIMA GRAND COMPLEX

PRISHTINA E RE

JETO LUKSIN NË ZEMËR  
TË PRISHTINËS SË RE.

CIMA GRAN COMPLEX

+383 49 50 90 90  
[www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)

Të lësh pas një jetë të ndërtuar në një nga vendet më të zhvilluara të Evropës dhe të nisish gjithçka nga e para në trojet shqiptare, kërkon guxim, vizion dhe një besim të palëkundur te vetja. Kjo është historia e Jetlira Zyfit, një gruaje që pas 26 vjetësh jete në Zvicër vendosi të rikthehej në Shqipëri për të ndërtuar jo vetëm një biznes, por një histori frymëzuese suksesi.

Sot ajo drejton “Medical Hills”, një nga qendrat më të njohura të estetikës në Shqipëri, ndërsa së bashku me bashkëshortin e saj ka ngritur edhe disa sipërmarrje të tjera.

Në këtë intervistë Jetlira rrëfen sfidat e rikthimit, sakrificat personale, filozofinë e saj të punës dhe besimin e madh që ka te potenciali i shqiptarëve për të ndërtuar të ardhmen në vendin e tyre...

**Jetlira Zyfi** la Zvicrën për të ngritur **“Medical Hills”**, perandorinë e estetikës dhe bukurisë në Shqipëri

## Në ballinë: Jetlira Zyfi

**Jetlirë, jeni e lindur dhe e rritur në Zvicër. Keni jetuar 26 vjet atje. Çfarë u shtyri të lini një jetë të ndërtuar atje dhe të riktheheni në trojet shqiptare për të ndërtuar diçka nga e para?**

- Në radhë të parë, dashuria...

Pas 26 vjetësh jetë relativisht monotone në Zvicër, fillova të reflektoj më thellë mbi atë që dëshiroja realisht nga jeta.

E kuptova se kërkoja një lidhje më të fortë me rrënjët e mia.

Si shqiptare ndjeva se vitet e mia më të mira nuk doja t'i kaloja duke kontribuar vetëm për një vend të huaj, por doja t'i investoja në vendin tim.

Së bashku me bashkëshortin kishim vizione të qarta dhe një dëshirë të fortë për të dhënë kontributin tonë në zhvillimin e Shqipërisë. Rikthimi nuk ishte i lehtë, por ishte një vendim i ndërgjegjshëm për të ndërtuar diçka me vlerë dhe për t'u bërë pjesë e ndryshimit që dëshironim të shihnim.

Pikërisht, kështu lindi ideja për të krijuar një klinikë estetike me standarde të larta evropiane...

**Rikthimi nga diaspora në vendlindje shpesh shihet si sfidë. Sa e vështirë ishte për ju të transformoni një vizion personal në një realitet biznesi në Shqipëri?**

- Ishte shumë e vështirë. U gjenda në një vend që ishte, njëkohësisht, i njohur dhe i panjohur për mua.

Nuk e zotëroja mirë gjuhën, nuk kisha një rreth të konsoliduar shoqëror apo familjar dhe nuk kishim kapital të madh për të nisur.

Ishim vetëm unë dhe bashkëshorti im në Tiranë, duke filluar gjithçka nga zero. Por, pikërisht këto vështirësi na forcuan dhe na bënë më të vendosur.

**Sot, pas pesë vjetësh, një pjesë e madhe e klienteles suaj vjen nga diaspora dhe turistët. Çfarë mendoni se i bën shërbimet tuaja shumë të kërkuara?**

- Shqipëria dhe Kosova janë bërë gjithnjë e më të njohura për shërbimet estetike. Ne kemi arritur të konkurrojmë me tregje të mëdha edhe falë kostove më të favorshme, por mbi të gjitha falë cilësisë.

Sot rreth 70 për qind e klientëve tanë vijnë nga diaspora dhe turizmi mjekësor. Ata nuk zgjedhin vetëm çmimin, por edhe profesionalizmin, sigurinë dhe rezultatet. Në trojet shqiptare kemi mjekë shumë të aftë, të trajnuar dhe me përvojë, gjë që e bën produktin final jashtëzakonisht konkurrues në nivel ndërkombëtar.

**Si pronare e "Medical Hills", cili ka qenë momenti kur kuptuat se projekti juaj po shndërrohej në një histori suksesi?**

- Momenti vendimtar ishte kur investimi në marketing filloi të ulej, ndërsa klientela vazhdonte të rritej.

Atëherë kuptova se "Medical Hills" kishte hyrë në një fazë tjetër. Klienti u bë "influ-

enceri" ynë më i mirë.

Rekomandimet, besimi dhe fjala e mirë nga goja në gojë janë treguesit më të fortë se po ndërton diçka të qëndrueshme...

**Ju drejtoni jo vetëm një klinikë të njohur, por edhe disa biznese të tjera së bashku me bashkëshortin. Si ndërtohet balanca ndërmjet partneritetit në jetë dhe partneritetit në biznes?**

- Kërkon një ndarje të qartë ndërmjet jetës profesionale dhe asaj private, edhe pse kjo nuk është gjithmonë e lehtë.

Në biznes një femër duhet të jetë shpesh me energjinë e mashkullit: të jetë shumë e fokusuar, vendimmarrëse dhe e fortë.

E, në familje ka mundësinë të jetë thjesht femininë, vetvetja, bashkëshorte dhe nënë.

Bashkëshorti im e kupton këtë ekuilibër dhe pikërisht aty qëndron forca e partneritetit tonë...

**Sa ka pasur ndikim formimi dhe kultura zvicerane në mënyrën se si i menaxhoni ekipet dhe bizneset?**

- Shumë. Zvicra ka një nga kulturat më të forta të disiplinës dhe etikës së punës në botë. Aty kam mësuar strukturën, profesionalizmin, komunikimin korrekt dhe rëndësinë e përgjegjshmërisë.

Ndonjëherë kolegët më thonë me humor se e marrë punën tepër seriozisht, por pikërisht ky standard më ka ndihmuar të arrij rezultatet që kam sot.





### **Në një industri si estetika, ku besimi është gjithçka, si arrini të ndërtoni marrëdhënie afatgjatë me klientët?**

- Gjithçka nis nga organizimi dhe kujdesi ndaj klientit. Ne kemi ndërtuar një databazë digjitale me mbi 5000 klientë të regjistruar, gjë që na ndihmon të mbajmë komunikim të vazhdueshëm dhe të kuptojmë më mirë nevojat e tyre. Kur klienti ndjen se po dëgjohej dhe vlerësohet, atëherë lind besimi. Dhe, besimi është themeli i çdo marrëdhënieje afatgjatë...

### **Shumë gra ëndërojnë të krijojnë diçka të madhe, por hezitojnë të bëjnë hapin e parë. Ç'do t'u thoshit?**

- Të fillojnë sot. Momenti perfekt nuk vjen kurrë. Gjithashtu, do t'u thosha ta marrin seriozisht pavarësinë e tyre financiare. Vetëbesimi dhe liria për të zgjedhur vijinë edhe nga stabiliteti ekonomik...

### **Sa sakrificë ka pasur rrugëtimi juaj personal dhe profesional?**

- Shumë. Për të arritur këtu ku jam sot, më është dashur të lë pas versionin e vjetër të vetes. Kam kaluar zhgënjime, kam parë njerëz të largohen dhe marrëdhënie të ndryshojnë. Por, në vend që këto situata të më ndalnin, i kam kthyer në motivim për të ecur përpara. Në të njëjtën kohë, gjatë këtyre viteve, jam bërë edhe nënë e dy fëmijëve. Kjo më ka dhënë një forcë të jashtëzakonshme dhe më ka bërë edhe më të vendosur si grua dhe sipërmarrëse...

### **Nëse ktheheni pas, si vajzë e rritur në Zvicër që vendosi të rikthehej në**

### **Shqipëri, çfarë do thoshit sot?**

- Do të thosha se ishte vendimi më i mirë i jetës sime; Se gjithmonë kam ditur të përballem vetë me sfidat; Se rruga do më çojë drejt njerëzve të duhur dhe mundësive që do e ndryshojnë jetën time.

### **Në pesë vjetët e fundit ju dhe bashkëshorti juaj keni ndërtuar disa kompani të suksesshme. Cili ka qenë sekretit?**

- Nuk ka sekret. Ka vetëm shumë punë, përkushtim dhe këmbëngulje. Të qëndrosh i bashkuar, të mos humbasësh fokusin dhe të mos harrosh kurrë vizionin që ke vendosur që në fillim...

### **A mendoni se diaspora shqiptare mund të luajë rol vendimtar në zhvillimin ekonomik të vendit?**

- Absolutisht, po. Madje, mendoj se tani është momenti ideal. Shqiptarët që jetojnë jashtë kanë fituar përvojë, njohuri dhe kapital. Nëse këto burime rikthehen në vendlindje, ndikimi mund të jetë transformues për ekonominë dhe sipërmarrjen shqiptare.

### **Estetika sot lidhet gjithnjë e më shumë me vetëbesimin. Si e shihni këtë transformim?**

- Nuk mendoj se vetëbesimi duhet të mbështetet vetëm te pamja e jashtme. Por, nëse një përmirësim i vogël estetik e ndihmon një person të ndihet më mirë me veten, atëherë kjo është diçka pozitive. Sot njerëzit kërkojnë rezultate natyrale dhe përmirësime të balancuara, jo transformime ekstreme. Në shumë raste

kemi ndihmuar të rinj që kanë vuajtur nga bullizmi për shkak të një tipari fizik. Kur një ndërhyrje e vogël mund t'u ndihmojë të rifitojnë vetëbesimin, kjo është një nga kënaqësitë më të mëdha të profesionit tonë.

### **Cili është vizioni juaj për "Medical Hills" dhe bizneset e tjera në vitet e ardhshme?**

- Jemi të fokusuar te inovacioni, ndërtimi i një marke të fortë dhe krijimi i sistemeve që mund të rriten pa humbur cilësinë. Objektivi ynë është rritja e qëndrueshme, forcimi i pozicionit në treg dhe zgjerimi i mëtejshëm përmes profesionalizmit dhe rezultateve të matshme.

### **Nëse do ta përshkruanit historinë tuaj me një fjalë, cili do të ishte mesazhi juaj?**

- Rrugëtimi drejt suksesit është i mbushur me sfida, pengesa dhe humbje, por fokusi duhet të mbetet gjithmonë te zgjidhja dhe jo te problemi. Kur ke vizion, punon shumë dhe nuk dorëzohesh, gjithmonë gjen rrugën për të ecur përpara...

### **Në vend të përfundimit...**

Historia e Jetlira Zyfit është më shumë sesa historia e një sipërmarrëseje të suksesshme. Është historia e një vajze shqiptare që u rrit në Zvicër, por zgjodhi të investojë energjinë, dijen dhe ëndrrat e saj në vendin e origjinës. Një dëshmi se kur vizioni bashkohet me punën e palodhur, kufijtë gjeografikë humbasin rëndësinë dhe sukcesi bëhet vetëm çështje kohe...

**Nderim Neziri**



# Si para 100 vjetësh - si tash: Mjerë vatani, mjerë mileti!

*Kudo në botë politikanët e partive të ndryshme bashkëpunojnë kur është në interes të shtetit dhe këtu nuk ka asgjë të keqe.*

*Por, a ndodh kjo edhe te ne, në Kosovë?*

Në Kosovë politikanët tanë e mbrojnë me mish e shpirt interesin e vet, pastaj atë partiak, të cilin na e shesin si interes kombëtar!

E, nëse u mbetet kohë për ndonjë gjë tjetër, merren edhe me ndonjë interes të familjes, të mëhallës, të katundit a të anës prej kah kanë ardhur...

Ky ilustrim u rri më së miri politikaneve tanë, të cilët, me gjasë, janë të vetmit politikanë në botë që e kanë në shpirt se nuk ka bir nëne që i ndërrojnë nga vendet që i kanë, thuajse i kanë me tapi!

Dhe, duke e shfrytëzuar këtë maksimum, politikanët tanë i hapin

krahët dhe japin deklarata nga ma të ndryshmet, duke e ngritur veten në pedestal.

Andaj, fjalët "Mjerë vatani, mjerë mileti" i shkojnë përshtati kohës në të cilën jetojmë...

## CILAT KATUNDE TË PRISHTINËS DO TË ZHDUKEN SË SHPEJTI?

Disa katunde të komunës së Prishtinës që nga paslufta janë me pak njerëz, për të mos thënë të boshatisur plotësisht.

Disa katunde, si, bie fjala, Mareci, Hajkobilla, Radasheci, Gillogovica, Prapashtica etj., më shumë komentohen si vende se dikur kishte banorë në to sesa si vende se në to banon ndokush...

Sepse, të gjitha familjet që jetojnë në këto fshatra, po të tubohen në një vend, nuk bëjnë sa një lagje e dikurshme e cilitdo fshat që e përmendëm...

## KURRË S'KA ME U BË MIRË!

Del paksa qesharake kur thuhet se kurrë s'ka me u bë mirë, por këto fjalë i dëgjova ditë më parë nga një udhëtar në autobusin nr. 4, i cili qarkullon në relacionin Gërmi-Matiçan.

I moshuari, i cili ishte ulur përballë meje, pas fjalëve që ndërruam ndërmjet veti, pashë se ishte i mllëfosur me gjendjen aktuale politike te ne ku një parti thotë se do ta zgjedhim me kohë presidentin e Kosovës e tjetra thotë s'jemi askund...

Unë, që t'i jepja pak vullnet për jetë në pleqërinë që e kishte, i thashë: "Mirë e bën Zoti!"

"Pasha një allah, që ma ka dhënë shpirtin, kurrë s'ka me u bë mirë!", ma ktheu me shumë nervozë.

"Eu, ç'më zuri taksirati?!", e solla në mendje dhe në stacionin e parë zbrita nga autobusi, vetëm e vetëm që të qetësohesha pak...



# 27 VJET PAS LUFTE, HË, ÇKA?!

*Çuditërisht, gjatë këtyre viteve, kryesisht, pjesa dërmuese e popullit ka heshtur, ka pritur realizimin e ëndrrave të shumta, ditë të mira në liri, në mes njëri – tjetrit më shumë dashuri, solidaritet, por edhe pak jetë, që, s'paku, të mos i shkojë mendja dikujt të ikë nga Kosova...*

Çuditërisht, them prapë, populli im ka lejuar që shtetin e ardhshëm ta definojnë ekstremistët dhe profiterët politikë!

Ka lejuar që në kokë t'na hipin politikanë anal-fabetë, ministra diletantë, e që pushtetin e kanë shfrytëzuar për të rritur pasuritë e tyre dhe për të punësuar farefisën e pashkollë!

Ka lejuar që themelet e pavarësisë së shumëkërkuar të na i ndotin tenderët, korrupsioni, trafikimi, kontrabanda!

Ka heshtur populli!

Ka duruar Kosova!

E, tash, është momenti që populli të mos heshtë më!

\*

Bota i ka mbi tetë miliardë banorë.

Dhe, dola unë të jem shqiptar, njëri nga miliona shqiptarët në këtë rruzull tokësor.

Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja të them

pse u linda shqiptar, madje as atëherë kur ishim nën robëri, as në pamundësitë për realizimin e shumë ëndrrave...

Aq më mirë, madje, që jetova në robëri, që t'ia dija shumë më shumë vlerën lirisë.

Por, njeriut i takon të ketë edhe të tjera ëndrra, si ndërtimi i shtetit me të gjitha të mirat e mundshme: shkollimin, punësimin, lirinë, demokracinë... Mirëpo, disa synime mbetën edhe sot ëndrra... Gjithmonë e kam arsyetuar veten me thënien: hajt se bëhet mirë... hajt se vjen edhe ajo ditë kur mund t'i realizoj dëshirat...

Por, ja që, ani pse po frymoj në Kosovën time të lirë, nuk po e shoh atë Kosovën time të ëndrrave...

Shoh shumë njerëz me halle, të brengosur, të zhgënjyer, por edhe me lot për të siguruar kafshatën e gojës!  
Keq!

**Gani DILI**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu Bajoku

**Dizajni:**

Labinot Bërbotovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)

Shumë e rrallë...



# Cila familje shqiptare i ka 500 anëtarë e t'fiu?

*Në mesin e më se 10 mijë shqiptarëve nga Lugina e Preshevës në Zvicër, janë edhe familja Seferi, nga Presheva. Ata janë atje që afro 60 vjet.*

Mjafton të përmendet Mustafë Demiri, i cili i pari qeli "meqaven" e kurbetit. Ai fillimisht erdhi vetë, e më vonë, si lokomotiva që tërheqë vagonët, tërhoqi edhe vëllezërit e tij një nga një: Hysenin, Milaimin, Fehmiun (i ndjerë).

Mustafa, "lokomotiva" e familjes Demiri nga Presheva në Lusanë, e që atje jeton nga viti 1968, asnjëherë nuk e ka hequr plisin dhe e mban me krenari.

Ata janë krenarë që jetojnë në Zvicër, sepse u kanë kontribuar së pari familjeve të tyre në Preshevë, e pastaj edhe vendit në mënyra të ndryshme, përmes një sërë aksionesh humanitare. "Nuk është mirë me e lënë vendin, atdheun, por nganjëherë koha dhe kushtet ta imponojnë deshe a s'deshe dhe këtu s'kemi ardhur për qejf, por me puna e fitua dhe një ditë të kthemi kah kemi ardhur, se vendi i huaj nuk

bëhet i yti", pat thënë para një kohe Mustafë Demiri.

Çdo vit familja Demiri, nga Karadaku Seferi në Preshevë, e që jetojnë e vepron në Lusanë të Zvicrës, tubohen, mbajnë mbledhje, organizojnë kuverndin e tyre vjetor...

Numri i anëtarëve të familjes së tyre tashmë e ka kaluar që moti numrin 500 e t'fui... Mrekulli, a?

# A do ta ketë Kosova më një Sefë Mleçan?

*Dikur kanë qenë një familje këngëtarësh, nën krahun e të papërsëritshmit Sefë Mleçani (1918-1975).*

*Edhe tani janë të gjithë këngëtarë me nam, megjithëse tre djem të Sefës nuk janë më.*

*Imeri, Osmani dhe Brahimi janë ata që trashëgojnë traditën. Ata, jo vetëm që janë këngëtarë të njohur dhe njihen si "Bijtë e Sefës", e që ftohën në dasma e ahengje, por ende veprojnë si tre trupa me një zë.*

*Ata nuk mund t'i imitojë askush dhe ende janë në formë të ndezin ndejën e adhuruesve të vet.*

*Sefa dhe bijtë e Sefës, thjesht, janë të papërsëritshëm...*



## ÇKA E KA BËRË SEFË MLEÇANIN TË MADH?

Një rigë shiu lag lapidarin e dy dëshmorëve në hyrje të fshatit Mleçan, të komunës së Malishevës, në ditën që e vizitua familjen Mleçani në vitin 2011. Familja e Sefë Mleçanit i kanë dhënë shumë Kosovës: Tre djem të rënë për Kosovë, një vuajtje për vajzën dhe katër palë përkuajdesje për jetimët e tyre, si dhe një shtëpi meshkuj të papërsëritshëm për këngë sharkie, të cilët e mbajtën gjallë jetën patriotike kundër Serbisë.

Në pasditen e së shtunës që i vizitua, oda e shtëpisë së Mleçanëve kumbonte nga kënga e tre djemve të një zëri: Imerit, Osmanit dhe Brahimit, të cilët sa herë tubohen bashkë, aty ku edhe i ruajnë muret e kullës së gurit të babës Sefë, këndojnë këngët e traditës së kësaj shtëpie, që nga gjyshi Ibrahim Gashi.

Shtëpia e trashëgimisë së rapsodit të madh, Sefë Mleçani, ka pasur fatin e hidhur edhe në historinë e luftës së viteve 1998-1999. Ajo ia mori dy djem: Beqirin dhe Ismetin.

I pari trashëgimtar i Sefës thuhet se ishte unikat, bashkë me Ismetin e rënë, ndërsa Xhaferi është vrarë në rrethana misterioze me të mbaruar ushtrinë, kur po e vuante burgun ushtarak në Idrizovë të Maqedonisë.

## SEFA KËNDONTE ME ORË TË TËRA...

Sefë Mleçani, i njohur në popull si Sefë Brahimi, ishte njeriu që vuajti shumë. Pavarësisht se i kishte kryer vetëm katër vjet shkollë në gjuhën serbe, jeta e bëri të ndjeshëm dhe të shkathtë të manovrës me tekste këngësh pa mbajtur shënime, falë mbamendjes dhe talentit. Jeta e kishte bërë t'i përngjante Zef Serembes, që vargjet t'i ruante vetëm në kokë.

Ishte i jashtëzakonshëm dhe ndër të vetmit rapsodë i cili këndonte pa tekst para vetes, madje pa e ngatërruar asnjë rresht!

"Baba kishte jetë tepër të vuajtur dhe jeta e tillë e bëri t'i mbante në mend këngët. Ishte mishëruar me këngët në stilin "Kënga është vaji i burrit"! Baba Sefë këndonte si askush tjetër", shpjegon Imer Sefë Mleçani, djali i madh i Sefës, shoku i parë i babës në odën e këndimit para burrave, qyshkur ishte shtatë vjeç.

Ai, duke përshkruar momente të jetës

me babë Sefën, në mes Osmanit dhe Brahimit, thotë:

"Baba ishte i vetmi mashkull në shtëpinë e tij. Nuk kishte vëlla e as motër. E kishin fejuar, por pak ditë para martesës i kishte vdekur e fejuara. E, baba i të fejuarës së vdekur vendosi t'ia jepte vajzën e vogël, katërmbëdhjetë vjeçe, Sadberen.

Ajo, në atë moshë, u bë gruaja e Sefës. Në natën që martoheshin, baba ishte lutur me dy reqate: "Zot, falmi 9 djem: 6 të jetonin, tre të vdisnin në luftëra!". Ishte disi si profet, sepse ashtu qysh kërkoi edhe ndodhi...

Baba arriti ta mbushte shtëpinë djem. I bëri me nënën 9 djem e dy vajza. Dy djem vdiqën qysh herët në moshën katër e pesëvjeçare, ndërsa shtatë u rritën dhe u bënë burra, bashkë me dy motra.

Njëri u vra në rrethana misterioze në burgun ushtarak të Jugosllavisë dhe dy djem ranë në luftë si ushtarë të UÇK-së", tregon këtë kapitull jete të dhimbshme Imer Mleçani, djali i madh i rapsodit Sefë Mleçani në odën e tij në Mleçan.

## U PËRMBUSH AMANETI I SEFËS...

"Kur u vranë Beqa dhe Ismeti, u thosha vëllezërve mos ta marrim shumë tragjike, sepse edhe lutja e babës në natën e martesës ishte siç kishte kërkuar, prandaj amaneti i tij përmbushej.

Baba ishte i aftë që aty për aty të formulojë vargje nën tingujt e sharkisë, për t'i argëtuar dashamirët e vet, që e përcillnin kudo që shkonte", thonë Osmani dhe Imeri në prani të Brahimit, i cili i dëgjon rrëfimet për vuajtjet e babës, pa llogaritur edhe atë kur Sefë Mleçani ishte ndarë nga UDB-a për transferim në Tivar, ku u vranë mijëra shqiptarë. Babën e kishte shpëtuar një njeri që e kishte hequr nga rreshti me kërkesën e kamufluar se ky i duhej Kosovës...

Imeri dhe Osmani këngët i mësuan nga babai.

Dhe, në odën e tyre, teksa tregojnë si i kanë mësuar këngët, lidhur me këtë, thonë:

"Nuk ishte problem t'i mësonim këngët, por s'kishim instrumente. Mësuam që nga trangu i tallës së misrit ta bënim çiftelinë. Pjesën e tallës e gdhendnim në formë çiftelie dhe nga ajo nxirnim tinguj.

Në skamje mësuam ta imitonim babën aq sa dinim dhe t'i mësonim këngët. Ai ende këndonte i vetëm, pa u shoqëruar

nga askush dhe ishte një krijesë unike që nuk mund të mbulohej me dikë tjetër as nga zëri, as nga fuqia e këndimit me orë të tëra pa u ndalur. U bë më i kërkuari në oda dhe dasma, u bë i pazëvendësueshëm për këndimin e këngëve të ciklit të kreshnikëve dhe të trimërisë, por edhe të zhanreve të tjera. Mua më merrte në oda e dasma që nga mosha shtatë vjeç. Më bëri shokun e parë, me të cilin i këndonte këngët", tregon Imeri dhe vazhdon tregimin: "Duke më bërë shok të këngës, ai e lehtësoi vetveten, sepse u bëra krah i tij. Më vonë në ndihmë na erdhi edhe Osmani...

Dhe, kur u bëmë tre vetë (babë Sefa me dy djem), u bëmë ekip dhe një zë i për-bashkët, kurse puna u bë më e lehtë... Andaj, ku ishim ne, të tretë, kumbonte oda në dasma e ndeja rasti, e që ishin të përditshme...

Më vonë na u bashkëngjiti edhe Brahimi, i cili kreu shkollën e muzikës dhe ishte i shkëlqyer, e që i dha fuqi tërë procesit të këngës në shtëpinë tonë", përfundon Imeri këtë pjesë të përjetimeve me babën Sefë Mleçanin.

## PSE I PËRCILLTE UDB-a SEFË MLEÇANIN DHE TË BIJTË E TIJ?

Sefë Mleçani me të bijtë ka luajtur rol të jashtëzakonshëm në krijimin e patriotizmit te brezi i ri. Aty merrej frymëzimi i parë i gjeneratave të reja, me motivimin se liria e Kosovës vjen vetëm përmes luftës me Serbinë.

Për këtë qëllim, ata, në shumë dasma, janë përcjellë nga UDB-a. Por, Sefë Mleçanin me të bijtë i ka ruajtur publiku, që të mos bien në kurth të pushtetit.

Kanë kënduar pa censurë vetëm kur u është thënë "oda është e juaja"! Këngët kreshnike kundër kralëve serbë gjithmonë kanë qenë ato që e kanë ndezur fitilin ndëretnik serbo-shqiptar dhe nuk ka këngë e këtij cikli që nuk e ka një porosi, kur ato i dëgjon në cilëndo mënyrë.

Dhe, duke folur për ekipin muzikor të rapsodëve, Imer Sefë Mleçani thotë se si djali i parë i Sefës ishte adhures i madh i këngëve dhe mburrej me babën që vuri themelin e dashurisë ndaj këngëve folklorike në shtëpi.

"Ka qenë zor me e ndjekë babën në këndim. Ai ka kënduar 24 orë pa u ndalur.

Baba nuk ka ditur të pushojë...

Shumë këngëtarë kanë pushuar ndër-

mjet këngëve, ose duke e zëvendësuar zërin me telat e sharkisë.

Baba kur u hynte këndimit të këngëve të Mujit e Halilit, nuk ndalej deri në fund dhe ato këngë, siç dihet, nuk kanë zgjatur një orë, por disa orë rresht. Babë Sefa nuk ka bërë hile në këndim, por ka bërë histori burrërore kudo që ka shkuar...

Kur i këndonte këngët e Mujit e Halilit, më duket edhe tash sikur e shoh kah e përjetonte historinë, sepse ishte i pasionuar në rrugën e këtij misioni, ku kënga kishte mesazh e porosi për gjeneratat e reja.

Nuk belbëzonte asnjëherë, sado të gjata të ishin tekstet e këngëve...

Ne nuk dimë që baba t'i ketë lexuar në letër ndonjëherë tekstet e këngëve që i ka kënduar...

Nuk dimë si i ka formuar ato dhe nuk dimë si i ka mësuar, por dimë se gjithmonë i ka kënduar njëjtë, pa e ndryshuar asnjë fjalë...

Dhe, kur e ke dëgjuar qoftë edhe për të njëqindtën herë cilëndo këngë të tij, ajo ka qenë e kënduar si herën e parë, pa u ndryshuar asnjë fjalë dhe pa e ndryshuar as tonin e këngës.

Pra, kishte aftësi të madhe për t'i mbajtur mend këngët. Ka qenë arkiv në mbamendje të këngëve...

Edhe ne, tash, kur këndojmë, i kemi po ato këngë, po ato tekste dhe po atë ton këndimi...

Kur kam filluar të këndoj me babën, i kam pasur shtatë vjet, e baba ishte rreth të tridhjetave. Kemi kënduar së bashku deri në vitin 1973.

Në atë kohë, babës i ra hise ndërrimi i shokut, sepse ashtu erdhën rrethanat. Me babën u bë shok Osmani, që kishte zë të fortë ashtu sikur e ka edhe sot...

Dhe, jo vetëm zë të fortë, por edhe shumë të thekshëm e melodik.

Por, ai që përshtatej më së miri me babën ishte Brahimi, e pak më vonë edhe Beqiri, që i tejkaloi të gjithë, duke u bërë enciklopedi muzikore në oda.

E, kur u bëmë shumë vetë në grup, më nuk ishte brengë këndimi, por UDB-a. Ata na përcillnin përmes spiunëve të vet nëpër dasma...

Dhe, kur kishte elementë të tillë në oda, zakonisht, na e bënë me dije se duhej ta censuronim veten nga këndimi...

Në atë kohë filluan edhe arrestimet e shqiptarëve për mendim ndryshe, nga ç'ishte deri atëherë...

Dhe, karshi popullaritetit që bëmë në masë, nuk ishte e lehtë t'i rezistonim presionit të UDB-së, sepse kishte raste

kur publiku e dasmorët donin këngë që kishin syzhe luftërat shqiptaro-serbe", thonë të bijtë e Sefës në odën e tyre.

## REZERVIMI BËHEJ GJASHTË MUAJ MË HERËT!

Se janë kërkuar shumë bijtë e Sefës në dasma, tregojnë kërkesat e shumta me regjistër.

Osmani dhe Imeri rikujtojnë detajet:

"Kemi pasur kërkesa të mëdha, të cilat mezi i kemi përmbushur. Kemi qenë të zënë deri në gjashtë muaj. Terminët i kemi ditur vetëm duke i shfletuar shënimet.

Kur kemi kënduar me babën, e di se çmimi ka qenë 20 qese dhe kanë pasur vlerë.

Orari ynë ka qenë nga e shtuna pasdite e deri të hënën pasdite. Ka qenë program i gjatë dhe i larmishëm", thonë ata.

E, duke folur për kujtimet më të mira në dasma me babën, ata thonë se kjo ka ndodhur në Dobërdol te katolikët dhe në Siqevë.

"Në Tërpezë, Novosellë e Kleçkë dinin ta përjetonin më së miri këngën. Sa kam ngrënë hallvë në ato vende, po të kishte qenë baltë, do t'i kisha lyer të gjitha kulat dhe shtëpitë tona", i kujtojnë fjalët e Sefës.

## NË DASMËN E HAMËZ SHABAN JASHARIT...

"Një dasmë shumë e veçantë ka ndodhur në konakun e Jasharajve në Prekaz, kur është martuar Hamëz Shaban Jashari, ku ka pasur aq shumë krisma rreth nesh, sa kishim frikë se mund të ndodhte më e keqja duke kënduar mes atyre plumbave", tregojnë të bijtë e Sefës.

Sidoqoftë, në familjen e Sefë Mleçanit nuk do të shuhet kënga, themelet e së cilës i vuri Sefa, vazhduar përmes Imerit, Osmanit, Brahimit, Beqirit dhe të tjerëve.

Ajo tash do të profilizohet nga nipërit e Sefë Mleçanit, disa prej të cilëve e vazhdojnë shkollimin në fakultete dhe në shkollat e muzikës.

## RAPSODI QË I KALONTE PROFESORËT E LETËRSISË POPULLORE

Rapsodi i madh popullor e folklorik, Sefë Mleçani, i ka shërbyer edhe Univer-

sitetit të Kosovës, Degës së Letërsisë, në lëndën e letërsisë popullore, duke bashkëpunuar me Prof. Dr. Shefqet Pllanën, i cili e çmonte shumë rapsodin më në zë të kohës, Sefën.

E, vetë Sefë Mleçani do të bëhej figurë e madhërisme e ligjëratave të këtij lëmi në Fakultetin Filozofik në Prishtinë...

Ai, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nxiste dhe edukonte ndjenjat e atdhedashurisë dhe patriotizmit, që reflektonin këngët e njohura, ku kishte gjak e histori nga marrëdhëniet shqiptaro-serbe.

Dhe, në kuadër të kohës me shumë probleme të natyrave politike, këngët e Sefë Mleçanit mbetën frymëzim për brezat që do t'i sillnin liri Kosovës.

Këngët e tij ishin një mjet i parapërgatitjes së revolucionit, që u shfaqë në Kosovë në vitet 1970-1981, kur edhe ndodhën shpërthimet gjithëpopullore për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavinë e atëherëshme. E, në këtë kontekst, ngritjen e vlerave patriotike e kishte mundësuar edhe familja e Sefë Mleçanit, përmes profesorit të nderuar të Fakultetit Filozofik, Shefqet Pllanës.

## BIJTË E SEFËS NË FESTIVALET E FOLKLORIT BURIMOR

Trashëgimtarët e Sefë Mleçanit, që kënduan me të, janë pjesëmarrës të shumë festivaleve të këngës folklorike në Kosovë dhe më gjerë.

Një problem ishte sfidë e kohës: T'i rezistonin rrymës politike që i godiste shqiptarët në Kosovë.

"Kishte probleme të merrnim pjesë në festivale, ku i organizonin pseudokulturalistët, sepse këndimi duhej të reduktohej në nivel të kërkesave të tyre.

E, ne nuk e bëmë një gjë të tillë. Kur kishte kërkesa të tilla nuk merrnim pjesë fare, sepse nuk do të ishim vetvetja në ato evenimente.

Kemi marrë shumë herë shpërblime, kudo që e kemi përfaqësuar Kosovën...

Qëllimi ynë i fundit ka qenë o të marrim pjesë me atë që disponojmë origjinal, o të mos marrim pjesë fare me improvizime!", thonë Osmani e Brahimi.

Sidoqoftë, bijtë e Sefës kanë trashëguar shumë autoritet falë babait të tyre, sepse e gjetën të gatshëm tërë bagazhin folklorik, të cilin e kishte gatuar i rralli Sefë Mleçani.

Sefë Mleçani vdiq në vitin 1975.

**Safet Krivaça**

KU JANË, Ç'BËJNË...

# Pse kurrë nuk shkruhet për Ymer Shkrelin?

*Ymer Shkreli u lind më 1945 në Shkrel të Rugovës.*

*Shkollën fillore e kreu në Haxhaj të Rugovës, kurse Normalen e nisi në Pejë dhe e mbaroi në Prishtinë, ku edhe i vazhdoi studimet në Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës.*

Ymer Shkreli një kohë punoi mësimdhënës në shkollën fillore në Haxhaj të Rugovës, pastaj në shkollën "Faik Konica" në Prishtinë dhe në Shkollën e Mesme Bujqësore në Prishtinë; kurse nga viti 1968 deri më 1993 punoi në të përditshmen "Rilindja", në fillim gazetar e reporter i lirë, pastaj redaktor i faqeve të "Rilindjes për fëmijë". Në fillim të viteve 70 ishte kryetar i Rinisë Letrare të Kosovës dhe kryeredaktor i revistës letrare "Plejada", e cila qe ndaluar pas botimit të numrit të saj të gjashtë.

Ai një kohë ishte njëri ndër bashkëpunëtorët më aktivë dhe anëtar

i Redaksisë së revistës për humor e satirë "Thumbi".

Ymer Shkreli e ka provuar penën e tij pothuajse në të gjitha gjinitë dhe zhanret letrare.

Ka përkthyer dhe ka sjell në gjuhën shqipe një mori veprash të njohura të autorëve të huaj.

Ka botuar poezi dhe vepra për fëmijë, është autor i 13 romaneve: "Vjeshta e vdekur", në vazhdime në "Flaka e vëllazërimit", 1971, Shkup; "Njeriu në bisht", botoi "Rilindja", 1975, Prishtinë; "Vdekja në ajër të pastër", botoi "Rilindja", 1976, Prishtinë; "Bima e dreqit", botoi "Rilindja",

1981, Prishtinë; "Pikëpjekja", botoi "Rilindja", 1982, Prishtinë; "Rapsodi kosovare" (katër romane: "Kali i Trojës", "Heroi në gjumë", "Shpendkeqja", "Zeka i Zi"), botoi "Rilindja", 1986, Prishtinë; "Doracak për tjetër botë", botoi "Jeta e Re", nr. 4-5-6 /1986, Prishtinë; "Ura e xhehenemit", botoi "Rilindja", 1989, Prishtinë; "Azgal", botoi "Rilindja", 1993, Prishtinë, si dhe autor i mbi 20 dramave; i 13 radio-dramave etj.

Është shkrimtari më i vlerësuar me çmime letrare në Kosovë.

Nga viti 1993 jeton në Luzern të Zvicrës.

MË SHUMË SE NJË BANESË

*Një standard i ri jetese*



**DAAKONN**  
INVESTMENT



# Pse u ngrit në këmbë për mua plaku i Mirashit?

*Sillen mendimet e mia në dhomë. M'u kujtua një ngjarje në një odë të fshatit Mirash të Ferizajt. Ç'ndodhi atje?*

I kishte vdekur babai një moshatarit tim, që më quante dajë, por kurrë s'e kam ditur pse e kam dajë.

Babai më kishte vdekur moti, e unë kisha qenë i vogël ta pyesja pse e kishim dajë filanin e Mirashit që vinte në odën tonë.

U nisa të shkoja ta vizitoja dajën dhe kur arrita atje më thanë të hyja në odë. Më ulën kah fundi i odës, demek shkaku i moshës së re, por përballë një plaku. Pasi mbretëroi heshtja, u hapë biseda ngushëlluese.

Plaku, që e kishte pranë një kujdestar interpretimi, ofroi veshin afër tij dhe kujdestari i tregoi kush isha.

Plaku i dha të ngrihej, por të tjerët

reaguan, duke i thënë s'ka nevojë të ngrihej...

"Unë dua të shkoj te ai e jo ai të vjen te unë!", foli plaku.

Pasi u ngrit, ashtu i kërrusur, u afrua pranë meje dhe më mori ngrykë...

Diçka e madhe do ketë ndodhur që ai u ngritë e erdhi te unë, e solla në mendje...

"A i ke përngjarë babës?", më tha plaku posa u ulë afër meje. "Deri diku", i thashë. Pas këtij dialogu më tregoi se kishte qenë shok i idealit të babait tim, qyshkur kishin qenë ballistë në male dhe e kishin shkelur në këmbë Shqipërinë deri në Tivar.

Unë, për ta relaksuar situatën e krijuar,

që te të tjerët zgjoi interesim të madh ardhja ime në odë, i thashë:

"Unë mendova se vetëm pse jam i madh me trup të bëra përshtypje e u ngrite në këmbë për mua!

Por, po e tregoj një meselë: E pata gjetur një këlysh të vogël dhe e qova në shtëpi. Baba u qua nga vendi që ta shihte këlyshin. I thashë është i racës së mirë".

"Ky nuk bëhet qen i madh, sepse është pinok. Nuk na duhet qeni i vogël në oborr, sepse qenit të vogël askush nuk ia ka frikën, e të madhit po", më tha. E, unë mendova veç pse jam i madh me trup u ngrite në këmbë për mua...".

**S. K.**

*Ditë të vështira...*

# **Mos u bëfsh për doktor!**

*Mjeku, derisa të kontrollon, flet me tjetrin, e nuk e ka mendjen fare te ti...*

Stomatologu, pasi të ulë në “karrigen e frikës”, nis e flet me ndokënd në telefon.

E, edhe nëse e ke gojën plot shkumësa apo gjak, duhet ta mbash gojën hapur derisa ai e kryen bisedën me telefon... Kur fillon të punojë në dhëmbin tënd, ia kris muhabetit për politikë!

Se ndodhë kështu po e ilustruj me një shembull:

Para pak ditësh, derisa rrija ulur në karrigen e stomatologut me gojën hapur nga shkumësat, stomatologu nisi t'i shajë të tjerët e ta lavdëroj veten...

Dikur u mbusha vrer dhe i thashë: “Largomi shkumësat se më janë kapur për qiellze të gojës!”.

Pasi m'i nxori, i thashë:

“O dosti jem, prej kur jam këtu e ke ndal punën nja katër herë, duke folur me njerëz, e tash po bën lavd, a?! Po të ishe ti në rregull do e mbaje rendin në ordinancën tënde e nuk do veproje në këtë mënyrë!”.

“Kam shumë termine e nuk po di kah t'ia nis punës, rendit”, ma ktheu.

“Eh, ta tregon baca një mesele: Nastradin Hoxha kishte pasur shumë punë. Nuk i mbante në mend gjërat dhe, meqë i ishte zhvilluar harresa, i thotë gruas: “Më ndihmo, grua, ta kaloj harresën! Të premten e kam një punë. E, që të mos e harroj terminin merre këtë shkop dhe ma lë mbi tavolinë, në mënyrë që ta di se është e premtë”.

Gruaja një ditë lë shkopin mbi tavolinë dhe, me të hyrë Nastradini brenda, shkopi i përplasat në kokë.

Shpejt e shpejt i thotë gruas:

“Sot nuk është e premtë, grua, ç'dreqin e ke lënë këtu shkopin?!”.  
“Është nata e së premtes dhe u desh me e mbajt marrëveshjen”, ia ktheu ajo.

“Më dëgjo grua, nga sot në këtë shtëpi o shkopi o unë!”, i tha ai.

Kështu jeni bërë edhe ju mjekët, nuk po e dini kur është e premtë. Për shkop keni nevojë...”, i thashë me një qeshje, e që ishte më shumë ishte ironike.

**B. Bajrami**





# MARIGONA HILL

The fairytale is no longer a dream.  
It's home!





**MARIGONA**  
SUN

Meet the most exclusive  
way of living!



*Fatit s'i dihet...*

# Shqiptari i Shkupit - grua aktoren e famshme turke

*Aktorja e njohur turke, Ebru Ozkan, ka një lidhje shumë të veçantë me shqiptarët, jo vetëm për raportin nga ekrani, por ajo është e martuar me një shqiptar nga Shkupi, i cili që nga viti 2000 jeton në Turqi.*

Aktorja e njohur turke, Ebru Ozkan, e lindur në vitin 1978 në kryeqytetin e Turqisë, në Ankara, e njohur nga shqiptarët me rolin "Dilara" në serialin "Fate të kryqëzuara", ka shprehur vazhdimisht lidhjen e saj të ngushtë me shqiptarët.

Ajo është veçuar me rolin e saj prej zonje të vërtetë, siç edhe i ka hije, edhe me personazhin "Halidja", në njërin nga serialet më të pëlqyer në Turqi me titull "Zonja e çifligut".

Roli i fundit i Ebru Ozkanit është "Leyla Türk", në serialin "I paepuri". Sidoqoftë, aktorja e njohur turke Ebru Ozkan është martuar me Ertan Shabanin, shqiptar nga Shkupi, i cili, gjithashtu, është aktor i njohur në Turqi.

Çifti i famshëm i kinematografisë turke janë prindër të një vajze.

## **E, ERTAN SHABANI?**

Aktori Ertan Shabani, i lindur në vitin 1977 në Shkup, u shpërngul në Turqi në fillim të viteve 2000 dhe filloi aktrimin.

Deri më tash mori pjesë në dhjetëra seriale dhe prodhime të kinematografisë turke dhe renditet si njëri ndër aktorët më në zë.



**bashkëshortor Ebru Ozkan  
dhe Ertan Shabani**

# BOOM



**"Gjini Studio" në Gjakovë - kapitull i ri për industrinë e bukurisë në Kosovë**

Në Gjakovë është hapur një kapitull i ri për industrinë e bukurisë me inaugurimin e hapësirës së re “Gjini Studio”, një ambient modern, i rregulluar deri në detajet më të imta dhe i ndërtuar me një standard të lartë profesional.

Nën drejtimin e frizerit dhe makeup artistit të njohur Gjini Doda, studioja e re vjen me një staf të kualifikuar dhe një koncept të avancuar shërbimi, duke u shndërruar në një destinacion bukurie që mirëpret klientë jo vetëm nga Kosova, por edhe nga Shqipëria dhe diaspora.

Me këtë zgjerim, “Gjini Studio” forcon pozicionin si një nga studiot më të mëdha dhe më të rëndësishme në vend, duke ofruar një eksperiencë që ndërthur elegancën, profesionalizmin dhe kujdesin maksimal ndaj klientit.

Në këtë intervistë ekskluzive, Gjini Doda ndanë rrugëtimin e këtij zgjerimi, filozofinë e punës së tij dhe vizionin që e ka kthyer studioja “Gjini Studio” në një emër të besuar në industrinë e bukurisë.



## “Gjini Studio” në Gjakovë - kapitull i ri për industrinë e bukurisë në Kosovë

**Fillimisht, urime për zgjerimin e studios! Si lindi ideja për ta bërë këtë hap dhe çka u motivoi?**

- Ky zgjerim erdhi në momentin e duhur, si reflektim i rritjes dhe vizionit tim profesional.

Ishte një hap i natyrshëm që u krijua nga kërkesa në rritje dhe nga dëshira për të ofruar një standard më të lartë shërbimi.

**Nga studioja e mëparshme e deri te ky ambient i ri, i madh dhe shumë luksoz, si e përshkruani këtë rrugëtim profesional?**

- Ka qenë një rrugëtim që më ka formuar profesionalisht dhe më ka shtyrë gjithmonë drejt nivelit më të lartë. Çdo etapë ka kontribuar në ndërtimin e përvojës dhe identitetit tim si profesionist.

**Çfarë e dallon studion e re nga ajo e mëparshmeja, si në shërbime ashtu edhe në eksperiencën që u ofrohet klientëve?**

- Studioja e re sjell një standard më të avancuar, më shumë elegancë dhe një eksperiencë më të kuruar për klientin. Çdo detaj është menduar për të ofruar një shërbim më premium dhe më të personalizuar.

**Sa e rëndësishme ishte për Ju që ambienti i ri të kishte një identitet më modern dhe më luksoz?**

- Ishte shumë e rëndësishme, sepse ambienti është pjesë e identitetit të punës sonë dhe ndikon drejtpërdrejt në përjetimin e klientit.

**Si ka ndikuar besimi dhe mbështetja e klientëve në këtë zgjerim të biznesit?**

- Besimi i klientëve ka qenë themeli i çdo suksesi që kemi arritur. Pa këtë besim asnjë hap përpara nuk do të kishte të njëjtën vlerë.

**Sot je i njohur si frizer dhe makeup artist, cili ishte momenti kur e kuptove se ky profesion do të ishte rruga jote?**

- Në momentin kur e kuptova se pasioni im mund të shndërrohej në profesion dhe në një rrugë të qëndrueshme jete...

**A ka pasur sfida gjatë procesit të zgjerimit të studios dhe, nëse po, si i ke menaxhuar ato?**

- Sfida ka pasur, por përkushtimi dhe fokusi kanë qenë gjithmonë më të fortë se çdo vështirësi që është paraqitur.



**Çfarë shërbimesh të reja apo risi mund të presin klientët në këtë hapësirë të re?**

- Risi moderne, më shumë komoditet dhe një koncept më premium të shërbimit, i cili synon të ngritë përvojën e klientit në një nivel më të lartë.

**Sa e rëndësishme është për ty që klientët, përveç shërbimit, të ndihen edhe komodë dhe ta përjetojnë luksin e ambientit?**

- Është shumë e rëndësishme. Klienti duhet të ndjejë kujdesin dhe nivelin e studios në çdo detaj, jo vetëm në rezultatin final, por në gjithë eksperiencën.



**Pas këtij sukcesi dhe zgjerimi në Gjakovë, cilat janë planet dhe synimet Tuaja për të ardhmen?**

- Synimi im është të vazhdoj të zgjerohem dhe të sjell gjithmonë standarde dhe risi edhe më të avancuara në fushën e bukurisë.

**Deri ku kanë arritur terminet për nuse?**

- Sivjet interesimi është jashtëzakonisht i madh dhe terminet për nuse janë rezervuar shumë herët, çka tregon besimin e madh të klientëve.

**Mesazhi Juaj?**

- Mirënjohje për çdo klient që ka besim në mua dhe në "Gjini Studio"!

Falënderoj të gjithë ata që janë bërë pjesë e këtij rrugëtimi! Suksesi im i arritur është i përbashkët me ta...

**Nderim Neziri**





## Dasmat e personazheve publike që pritet të marrin vëmendje të veçantë në vitin 2026

Viti i sivjetmë 2026 premton të jetë një vit i mbushur me dasma të bujshme në botën e shoubizit. Disa nga çiftet më të njohura tashmë kanë kurorëzuar dashurinë e tyre, ndërsa të tjerë po përgatiten për ceremonitë që pritet të tërheqin vëmendjen e publikut...



### DUA LIPA DHE CALLUM TURNER

Dua Lipa dhe Callum Turner janë ndër emrat që kanë bërë më së shumti bujë. Këngëtarja me famë botërore ka kurorëzuar dashurinë e saj me aktorin britanik, duke shënuar një nga ngjarjet më të komentuar të vitit. Pas një romance të ndjekur nga miliona fansa, çifti ka hedhur hapin e madh drejt jetës së përbashkët.

### LOREDANA DHE KARIM ADEYEMI

Edhe Loredana dhe Karim Adeyemi, gjithashtu, i kanë thënë "Po" njëri-tjetrit. Në një ceremoni intime familjare, dyshja kurorëzoi dashurinë e tyre, ndërsa pjesë e këtij momenti të veçantë ishte edhe vajza e Loredanës, Hana. Lajmi u prit me entuziazëm nga ndjekësit e tyre...





## GIMBO DHE SELIN BOLLATI

Gimbo dhe Selin Bollati pritet të jenë një nga çiftet më të përfolur të kësaj vere. Fituesja e “Big Brother VIP Albania”, Selin Bollati dhe partneri i saj kanë bërë të ditur se po planifikojnë një dasmë madhështore gjatë sezonit veror, duke rritur edhe më shumë kureshtjen e publikut...



## BORA ZEMANI DHE DONALD VESHAJ

Ndërkohë, shumë vëmendje po merr edhe çifti Bora Zemani dhe Donald Veshaj. Pas disa vjet lidhjeje dhe bashkëjetese, dyshja duket se është gati për hapin e radhës. Ende nuk dihet nëse ceremonia do të jetë private apo do të ndahet me publikun, por fansat mezi po presin detaje të reja...

## NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Nuk janë vetëm këto çifte që do e kurorëzojnë dashurinë e tyre me martesë. Ka edhe çifte të tjerë... Sidoqoftë, mbetet të shihet se cilat nga këto dasma do të kthehen në ngjarjet më të komentuar të vitit, por një gjë është më se e sigurt: sezoni i dasmave të shoubizit sapo ka nisur...

**Edona Vllasaliu – Bajoku**

# 30% OFF

## ON 3 MONTH MEMBERSHIP



**UWA**<sup>®</sup>  
SPA · POOL · FITNESS

YOUR SUMMER  
STARTS HERE



*Celebrate Love*  
UNDER PRISHTINA'S  
BLUE SKY

RESERVE YOUR DATE



# Kë e kanë gomarët babë?

*U kërkohet falje deleve të mija që nuk mund t'i kullosojmë në kodrën time, sepse ish-kryetari i komunës e ka shitur apo ia ka falur dikujt sipërfaqen e gjelbëruar të kodrës...*

Zor është sot t'i rrish përballë ndokujt kur gënjen, apo, në ndonjë mënyrë tjetër, nuk e thotë të vërtetën. Paskësh shtruar dikush një darkë në odë dhe një burrë që paskësh qenë hajn e pyet hoxhën:

"Aga hoxhë, si e paguan njeriu hajninë edhe nëse nuk të kapë shteti?"

Hoxha i thotë:

"Nuk dihet ore burrë kush paguan, sepse mundet edhe nipi yt ta paguajë borxhin tënd nëse ke vjedhur!"

Burri hajn pas darke shkon të vjedhë një kalë në një shtëpi. E zgjidh kalin, por ai i bie shqelm dhe e rrëzon në ahur.

Me të dëgjuar zhurmën zgjohen burrat e shtëpisë dhe hyjnë në ahur, ku edhe e gjejnë hajnin të shtrirë. Hajni u thotë:

"Ma thirrni hoxhën!"

Burrat e shtëpisë e thërrasin hoxhën.

Hajni i thotë: "Aga hoxhë, pse më the se për hajninë time paguajnë nipat a stërnipat?! E sheh çka më gjeti mua!"

"Këtë e ke paguar për babagjyshin tënd!", ia ktheu hoxha.

## MË ËSHTË MËRZITUR POLITIKA...

Më është bërë bajat të flas a të shkruaj për politikë. Kisha dashur në këto çaste të jem bari e të ruaj bagëtinë. T'i kisha nja 100 krerë dele dhe t'i kullosoja në kodrën time.

Por, dëshirën ma prish uzurpimi i kodrës, sepse ish-kryetari i komunës njërit nga Maqedonia ia ka dhënë një truall për biznes të dhive mu te vendi i bukur, "Pishat". Më vonë ai e uzurpoi tërë kodrën me sa e sa hektarë...

Nuk më ka mbetur as të kem dëshira më, them me vete. Nuk mundet njeriu me këtë pushtet as të meditojë, sepse çfarëdo vendi të bukur natyror që ka ekzistuar, është uzurpuar a shitur nga shteti dhe nuk ka mbetur vend as për meditim...

"Më falni", u them deleve të paragjykuara, "kullotni ku të mundni se kodrën time e kanë uzurpuar njerëzit e shtetit!"

## OSE COFË GOMARI OSE VDES MBRETI...

Nuk po guxoj të flas tash se çka mendoj me vete për këto raste, por dua të shprehem me anë të një shembulli: Kish dal Nastradini në tregun ku shiteshin gomarët. Të gjithë e kishin çmimin nga 100 lira, pos njërit që shitej 15.

"Pse ky është më i lirë?", e pyet Nastradini shitësin.

"Sepse është babai i gomarëve dhe është më budallai nga të gjithë!", ia ktheu shitësi.

Po në atë kohë dëgjon mbreti se në pazar shitej babai i gomarëve.

E thërret Nastradinin që të mësojë më shumë për këtë rast.

Nastradini i tha se babai i gomarëve, edhe pse më plaku, mund të mësojë të lexojë, madje edhe të shkruajë!

Mbreti kur e dëgjoji se çka tha Nastradini, e pyeti:

"Nastradin, për sa kohë e mëson ti atë gomar të lexojë?"

"Për nja pesë a gjashtë vjet..."

Por, që ta mësoj gomarin plak të lexojë e të shkruajë më duhen para", i tha mbreti.

"Nastradin, të jap para sa të duash, por nëse nuk e mëson gomarin të lexojë ta heq kokën!", ia ktheu mbreti.

Nastradini i kërkoi mbretit 1000 lira që ta mësonte gomarin të lexonte brenda pesë vjetësh.

Dhe, mbreti ia dha paratë.

Nastradini e mori gomarin dhe paratë dhe u kthye në shtëpi.

Gruaja u befusua kur i pa gjithë ato para dhe iu drejtua Nastradinit:

"Ku i more gjithë këto para?!"

"M'i dha mbreti, me kusht që këtë gomar, që e solla në shtëpi, ta mësojë të lexojë brenda pesë a gjashtë vjetësh", i tha ai.

"Po ku mësohet gomari të lexojë, o njeri?!", ia ktheu ajo.

"Brenda kësaj kohe ose cofë gomari ose vdes mbreti!", ia ktheu Nastradini.

**Selim Rama**

# MANY EXPERIENCES ONE DESTINATION

MARINA BAY — WHERE THE SEA, THE STAY & THE NIGHT COME TOGETHER.

FINE DINING · ROOFTOP NIGHTS · CASINO  
SPA & WELLNESS · BEACH · SUNSET DINING  
SEA VIEW SUITES · EXCLUSIVE EVENTS



**MARITIM**  
MARINA BAY RESORT & CASINO  
★★★★★

[www.marinabay.al](http://www.marinabay.al)

VLORË, ALBANIA

@marinabayresort\_casino

Rrallë e përmallë

# Kohën e prishin burrat!

*Në ndeja dëgjojmë të thotë shumëkush se kanë ndërruar kohët. Ka qenë më mirë e u bë më keq... Kur e thonë këtë të vjetrit, e që kanë kaluar përvoja me Serbinë, mund të merret si konstatim me vend, por kur e dëgjon njeriu nga të rinjtë, kjo të vë në siklet!*

*Edhe këngëtarët e reja flasin në televizione, portale e gazeta dhe ankojnë se mbaruan me punë e angazhime... Çudi, a?!*

Më tha një ditë një mik imi se, sipas tij, kisha humbur prej kohësh.

"Mik, kohë nuk po kam!", i thashë.

"Dashtë Zoti të kesh para bile, me punën që bën!", ma ktheu ai.

"Më shumë jam në zor për kohë se për para, se para kam e koha nuk po më del të takohem me askënd!", ia ktheva.

A thua, kush i ndërron kohët?

Disa thonë vetë koha, disa politika e disa...

Për të dëshmuar se politikanët e ndërrojnë kohën, një rrugë në Prishtinë, të "Sahat Kulla", ka pasur disa emra, varësisht nga situata dhe ndërrimet politike...

Rruga që tash quhet "Ali Hadri" dikur quhej "Boro Vukmiroviq", më vonë "Zef Lush Marku", pastaj "Boro Kozarac"!

Pra, sa e sa kartolina duhet të rishikoheshin për ta kuptuar historikun e ndërrimit të kohëve...

Sa e sa letra mbajnë të dhëna e histori nga koha kur ishte primare të shkruhej bukur dhe pa gabime.

Sa e sa...

## HISTORI KA LËNË EDHE NASTRADIN HOXHA...

Nastradini punonte në arë.

Fqinji i thotë: "Nastradin, të gjithë i mashtron, por mua kurrë!"

"Lëri fjalët, por tash na vjen dreka e pastaj flasim", ia kthen Nastradini.

Nastadini e kishte lidhur lepurin për qerren që e kishte në ara, e zgjidhi dhe e mori në dorë.

I tha lepurit: "Shko dhe thuajti zonjës së shtëpisë le të sjell lepur të pjekur, kajmak dhe shurup!"

Ndërkohë e lëshon lepurin të vrapojë...

Dhe, nuk vonoi e gruaja ia solli në arë të gjitha që ishin marrë vesh t'i vinin për drekë...

Fqinji e luti Nastradinin t'ia shiste lepurin, se qenka i mençur.

E mori fqinji lepurin, pastaj shkoi në qytet dhe bleu mushkëri. Më pas doli në gjah e i tha lepurit: "Merri këto mushkëri dhe qoja gruas dhe thuaj t'i përgatis për drekë!"

E lëshoi lepurin dhe priste gruaja t'ia sillte drekën në mal, ku edhe ndodhej për gjah. Por, kot...

Kur shkoi në shtëpi e qortoi gruan.

"Pse nuk m'ï solle mushkëritë?!", i tha.

"Cilat mushkëri?! Qenke çmendur, ore!"

Burri e kuptoi hilen e Nastradini dhe i va-  
jti në shtëpi. Me të hapur derën Nastradini  
e kishte kapur gruan për flokësh dhe ia  
kishte vënë thikën në fytyrë.

E kishin kurdisur situatën ashtu që burri  
që erdhi, duke parë se Nastradini ishte  
çmendur, as që pat kohë ta përmendte  
lepurin...

Nastradini e gërvishti pak gruan dhe asaj  
i doli gjaku. Ajo u bë sikur do vdes. Në  
atë moment Nastradini mori fyellin dhe  
nisi t'ï bjerë, kurse pas pak gruaja nisi të  
lëvizë. Nastradini i tha burrit se fyelli është

magjik dhe e ngjallë gruan.

"A ma shet, pra, fyellin, o Nastradin, se  
gruaja më çmendit!", i tha fqinji.

Nastradini ia shiti fyellin.

Burri me të ardhur në shtëpi u grindë me  
grua dhe ia preu kokën. E mori fyellin ta  
rikthejë në jetë.

Kur pa se nuk ishte punë ringjalljeje, i tha  
vetes: "Meqë nuk po ringjallet menjëherë,  
po ia lë kohës".

Pas do ditësh takon Nastradinin dhe i  
thotë:

"E di hilen tënde, por ia kam lënë kohës!".

"Mirë ke bërë!", ia ktheu ai.

## HOXHA DHE PËRSHESHI

Por, edhe koha e ka një kohë...

Një fshatar kishte shkuar te hoxha për të  
kërkuar një sqarim.

Hyn brenda në faltoren e tij dhe ulet.

Hoxha në ato çaste po hante përslesh.

"Fol se po të dëgjoj", i thotë dhe nuk e  
ndalte dot përseshin...

Fshatari nisi t'ï tregonte për hallin që  
kishte:

"Hoxhë efendi, sapo e kam korrë grurin  
dhe për sivjet kam bukë për nja nëntë  
muaj. Dua t'më këshillosh se ku ta marr  
bukën edhe për tre muaj të tjerë?"

N'çast, hoxha nisi t'ï shpejtonte lugët, zu  
të hante më shpejt...

"Fol ti, fol...", i tha hoxha fshatarit dhe e  
mbushte lugën sa mundte me përslesh...

Dhe, kur e hëngri përseshin, hoxha i tha:

"Eh, more jaran, unë ngutesha që ta haja  
sa më shpejt përseshin, se frikësohesha  
mos ma merr Zoti shpirtin e më mbetët  
përseshi pa e hëngër, kurse ti mendon se  
çka do të ndodhë pas një viti!"

Atëherë, fshatari ngrihet në këmbë dhe i  
thotë:

"Ditën e mirë, hoxhë efendi!"

"Rri, ku shkon, o burrë?", i tha hoxha.

"Çka të flas tjetër kur ti nuk i beson as  
dakikut?!"

**B. Bajrami**



# Babë e bir urrejnë njëri-tjetrin!

Fqinji im punonte në kopsht.

"Çka do të mbjellësh këtu, se e paske  
lëruar mirë tokën?", i thashë.

"Dua të mbjell disa fidanë. Kanë për  
t'u rritur sa plepat, sepse në fshatin  
tonë është toka për pemë. Dhe, këtë  
punë po e bëj për inati të djalit!"

Eu, thashë vetë me vete, paska edhe  
kështu, a?!

Por, ka edhe më keq...

Tezaku im me djalin e tij janë inatxhi

të fortë mes vete. Më inatxhi se LDK-  
ja e "Vetëvendosja".

Nuk flasin me vjet mes vete.

Jetojnë si armiq, flasin si armiq, e  
janë babë e bir! Njëri-tjetrin e thërra-  
sin në emër.

Kur hyn në shitoren e fshatit tonë,  
tezaku im kënaqësinë më të madhe  
e ka kur flet keq për të birin e tij...

Pra, keq e më keq!

**T.**



## Nëma më e keqe: **Mbetsh vejushë!**

*“Në qoftë se ekziston femër në botë të ketë vuajtur shpirtërisht si unë, atëherë ajo do të ketë përfunduar në humnerë të pafund”, thotë Sadberja, 54 vjeçe, nga Suhareka.*

### SI E LËSHOVA UDHËN E ZOTIT?

“Ishte hera e parë që në vitin e fundit të shkollës së mesme po më rrokno do farë dridhjes të çuditshme, e që nuk më kishin goditur asnjëherë tjetër. I thosha vetes se isha ende e re, për të mos thënë fare e pamësuar dhe tej mase e frikësuar të nisja dashuriçkat e moshës që i takoja, edhe pse shoqet e mia nuk e qanin kokën për gjëra të tilla. Dhe, në këtë kohë, fillova të dal pak nga ajo “udha e Zotit”... Këtë devijim timin lozonjar e vërejtën menjëherë vëllezërit e mi, të cilët më ndaluan të dilja nga shtëpia pa i pyetur paraprakisht se kah do ta thyeja qafen. Për këtë arsye edhe humba besimin e tyre për të vazhduar shkollimin më tutje, pra studimet në Prizren, e që ishte një goditje e rëndë për mua dhe e para në jetën time.

### SHOQET E MIA DASHUROHESHIN, E UNË?

Dhe, deri në moshën 21 vjeçe jeta ime ishte e njëjtë: e zymtë dhe krejtësisht monotone, edhe pse kohëve të fundit kisha dal nga pak nga shtëpia, por nuk kisha njohur askënd. Në anën tjetër, të gjitha shoqet e mia kishin gjetur të dashurit e tyre, madje ishin

dashuruar edhe nga dy a tri herë... Pas një kohe njëra nga motrat e martuara më propozoi fejesë me një djalë që bashkëshorti i saj e kishte të afërm. Por, dola me të dhe nuk më pëlqeu... Po atë verë, për çudi, pa menduar gjatë, u fejova me një shok të vëllait tim të dytë, i cili ishte djalë me fakultet të kryer dhe pasuri të madhe në një fshat të komunës së Rahovecit, të cilit nuk dua t’ia përmend emrin, sepse tash më neverit. Për çudi, më pëlqeu që në takimin e parë. I tregova se nuk kam pasur lidhje me askënd, andaj të flinte rahat. Dasma u bë një të diel me shi, erë dhe bubullimë. Dhe, pika e vlimit tim ndodhi pas dy javësh, kur më thanë të shkoja në ahur dhe t’i milja lopët. Kundërshtova para të gjithëve dhe në atë moment burri im u ngrit në këmbë dhe më ra shuplakë. Më pas grushtimet e tij pasuan edhe në dhomën e fjetjes. Dhe, që nga ajo ditë, edhe pse bëra jetë me të një vit, mezi prisja të gjeja rastin t’i jepja fund martesës dhe të mos rrija asnjë ditë në atë shtëpi...

### JETA SI VEJUSHË

Jeta si vejushë ishte edhe më e rëndë se ajo kur rrija e mbyllur para martesë në shtëpi. Tashmë nuk më pengonte askush të dilja, por sa herë që dilja në rrugë më bëhej se të tjerët flisnin vetëm për mua.

Nuk më pengonte kush të dilja, por nuk e kisha freskinë e dikurshme. E ndjeja mungesën e një mashkulli, sepse veç isha mësuar të flija me dikë. Dhe, sa herë që dilja në qytet, veç sa dëshpëroheshja, sepse shumëkush mendohej të më shtinte në dorë, qoftë edhe për një natë. Në pranverën e vitit tjetër u njoha me një burrë që i kishte 33 vjet, me të cilin ramë dakord të martoheshim, meqë edhe ai kishte qenë i martuar një herë. Me t’u martuar për së dyti, u dhashë shqelm gjithë atyre meshkujve që më ndiqnin pas sa herë që dilja jashtë shtëpisë. Tim burrë në fillim fillova ta doja, por shumë shpejt filloi t’me dilte nga zemra. Më shkante në nerva për shumëçka. I thashë se jam e sëmur dhe nuk dëshiroja të nissja kurrfarë fëmije, të cilin ai e dëshironte shumë. Ky edhe ishte shkaku i një zënke shumë të ashpër, e cila edhe përfundoi me ndarje. Dhe, që nga ajo kohë, edhe pse kanë kaluar vite e vite, më nuk kam besim në askënd dhe si vejushë më shumë rri mbyllur sesa që dal nga shtëpia, sepse e kam emrin e keq: të gjithë më thërrasin vejushë. Andaj, nëse do me e nëmë dikë për të keq thuaj: Mbetsh vejushë!

**Diturie Haxhaj**



## Dizajnerja e modës **Liridona Hajdari** sjell elegancë moderne në tregun vendor

*Liridona Hajdari po konsolidon gjithnjë e më shumë praninë e saj në industrinë e modës, duke ofruar dizajne të veçanta që ndërthurin thjeshtësinë me elegancën moderne. E fokusuar kryesisht në krijimin e fustaneve solemne, marka e saj synon të theksojë finesën dhe individualitetin e çdo klienteje.*

E themeluar në vitin 2022, veprimtaria e saj është zhvilluar mbi një qasje të personalizuar ndaj modës, ku çdo detaj merr rëndësi të veçantë. Një nga karakteristikat kryesore të këtij biznesi është fakti se i gjithë procesi krijues, nga stili deri te qepja, realizohet nga vetë dizajnerja, duke garantuar kështu cilësi dhe identitet unik në çdo produkt.

Përveç koleksioneve të gatshme, Hajdari ofron edhe shërbime me porosi, duke i përshtatur dizajnet sipas kërkesave dhe dëshirave specifike të klientëve. Kjo fleksibilitet ka ndikuar në rritjen e interesit për krijimet e saj, sidomos në mesin e

atyre që kërkojnë veshje unike për raste të veçanta.

Sa i përket trendeve më të kërkuara, klientët po orientohen drejt modeleve me dizajn unik, të karakterizuara nga draping-u dhe stili klasik, ndërkohë që mbetet i lartë edhe interesi për fustane të dekoruara me gurë, të cilat shtojnë një prekje luksi dhe shkëlqimi.

Të interesuarit mund ta gjejnë dizajneren në Prishtinë, në rrugën C, si dhe në platformën Instagram përmes profilit "liridonahajdariofficial", ku prezantohen krijimet më të fundit dhe projektet në zhvillim.



## ***Politika më ndau nga i dashuri!***

*Deri para më pak se një vit isha në lidhje dashurie me një djalë që e doja shumë, ama shumë... E, edhe ai më donte...*

*Por, si duket, fati ishte i tillë që ne të mos jemi gjithmonë bashkë...*



Ulqini m'i lëvizi "fluturat" në bark!  
Çdo gjë filloi në Ulqin.  
Vend i mrekullueshëm se jo mahi...  
Në Plazhin e Madh kishte edhe njerëz të tjerë, kryesisht të rinj.  
Laheshin, qeshnin dhe flisnin me zë të lartë.  
Më bezdisi ky fakt dhe mundohesha të mos i dëgjoja se ç'flisnin...  
Ua ktheva shpinën dhe bëhesha sikur rrezitesha.  
Pas pak çohem për t'u larë dhe shoh se pas meje vjen një nga djemtë që laheshin më parë në det.  
Pas një noti të mirë bie mbi zall që të rrezitëm.  
Ai ishte shtrirë afër meje dhe më shikonte...  
Dikur u afrova edhe më afër dhe më tha: "Hyrë edhe një herë në ujë se dua të të them diçka".  
Nuk i thashë gjë, por vetëm qesha me ironi...  
Ai u ngrit, hyri në ujë dhe priste që të shkoja pas tij...  
Por, kur pa se nuk shkova, doli nga uji dhe

erdhi përsëri afër meje dhe u shtri mbi rërë...  
E solla në mendje: të çuditshëm janë djemtë - të ngacmojnë edhe pa të njohur, edhe pa ditur a ke ti të dashur a jo...  
Edhe të nesërmen veproji njëjtë, si një ditë më parë. Madje, këtë ditë edhe më pyeti si qushesha. Por, nuk i tregova...  
Dhe, nuk di as vetë nga e kishte mësuar, por më tha se ma di emrin...  
Mbetë e habitur kur tha emrin tim...  
Pas dite më erdhi një sms dhe një foto imja, duke u rrezitur në plazh...  
Oh, s'e keni idenë si më lëvizën "fluturat" në bark... E lexova dhe nuk i ktheva përgjigje.  
Pas nja dy orësh më erdhi një sms tjetër, ku më thoshte: "Ti do bëhesh e imja".  
Dhe, ndodhi si ndodhi, unë me familjen time pas tri ditësh përfunduam pushimin në Ulqin.  
Pas disa ditësh i shkrova një sms. "Të lutem, prej nga je?", e pyeta.  
"Jam nga Prishtina", ma ktheu.  
Dhe, që të bindem se ai, vërtet, ishte nga Prishtina, e që mua më shkonte shumë për shtati, e lus të më thërriste në telefon nga

një numër fiks.  
Nuk kaluan as pesë minuta dhe nga një numër fiks nga Prishtina dëgjova zërin e tij.  
Ishte po i njëjti zë që e kisha dëgjuar edhe në plazh, në kohën kur më pyeste si e kam emrin dhe që të hynim në ujë bashkë...  
Dhe, nga dita tjetër nisa të dalë me të kudo: në kafene, në shesh, në park...  
Kështu, me kohë dashuria jonë nisi të lulëzojë dhe mburresha me fatin që ma ofroi Zoti...  
Por, pas një viti bashkë, në një moment, u zumë keq, thuajse për hiçgjë, e që nuk ia vlente...  
"Mollë sherri" u bë politika, sepse ai ishte një adhurues i madh i partisë në pushtet. Tërë kohën nisi të fliste për politikë, për zgjedhje të reja, e çka jo tjetër...  
E, unë, meqë jam bijë e një aktivisti që ka bërë shumë për kombin, nuk ma lejonte ndërgjegjja të isha në vijë me të!  
Dhe, ndodhi si ndodhi më nuk jemi bashkë...  
U shua një dashuri e madhe për hiçgjë!

**Vitorja, Prishtinë**

12 - 15 QERSHOR

Cakto konsulten tende

# Dr. Johann Nemrava

Specialist i Kirurgjise Estetike dhe Plastike

+383 45 707 744



# 5 vjet jetë me një puthje!

*Kur i mbusha 20 vjet, sa rritesha aq edhe zbukurohesha. Ma kishin lakmi shoqet e mia për bukurinë që kisha, por edhe për sjelljet e mia korrekte me djem. Kur dikush më propozonte të dilja me dikë, së pari, ua kërkoja fotografinë që ta shihja se si dukej, e pastaj vendosja a të dilja për një kafe a jo... Një ditë, një shoqe imja, Jeta, ma ofroi një foto në të cilën dukej një djalosh zeshkan, e që në shikim të parë nuk më pëlqeu hiq. Por, me kohë gjërat ndryshuan...*

Kur ime shoqe Jeta, ma propozoi një dajë të vetin që të njihesha me mua, në fakt, si thashë jo, por pranova ta shikoja foton e tij njëherë.

Në foto, thënë të drejtën, s'më pëlqeu fare...

Sipas saj, ai ishte dhënë shumë pas meje... Por, nejtë, kështu filloi krimbi.

Thashë: "Mirë, të njihemi!"

Nuk ishte një takim si të tjerët kur njihen dy të rinj ndërmjet veti. U bë nëpërmjet telefonit me sms. Ai më shkroi i pari dhe unë ia ktheva mesazhin. Të nesërmen e lamë të takoheshim në qendër të Rahovecit, meqë në Xërxë më njihnin pothuajse të gjithë...

E mbaj mend edhe sot atë ditë.

Sa emociione kisha...

Por, mundohesha të përmbahesha.

Gjatë takimit, për çudi, më tërhoqi pjekuria, zgjuarsia edhe ngrohtësia e tij... Më dukej sikur njihesha prej kohësh.

Kemi qëndruar dy orë bashkë atë ditë, e mua m'u dukën si 10 minuta...

Dikur kërkoja leje prej tij dhe u largova,

sepse nuk doja ta kuptonte se më pëlqeu që në takim ta parë.

## KAFE E LLAFE 3 MUAJ RRESHT...

Ditët në vijim ishin të ngarkuara për mua: flisnim me orë të tëra në telefon, i shkruanim njëri-tjetrit sms pa reshtur...

E, kjo zgjati rrafsh tre muaj: takime, kafe e llafe... Kështu, ai u bë njeriu më i rëndësishëm për mua...

Por, pas tre muajsh disa ditë nuk u paraqit fare.

"A thua, çka i ka ndodhur?", e solla në mendje. Fillova të mërzitesha.

Kah mbrëmja më erdhi një sms nga ai.

Kërkonte të takoheshim nesër paradite dhe asgjë më shumë.

Të nesërmen, kur u takuam, në sytë e tij pash një zhgënjim. Dëshiroja ta puthja, por më mungonte guximi.

Filluam të bisedonim. Më tha se më nuk mund të takoheshim...

"Pse?", i thashë.

"Nuk mund të jem i yti përgjithmonë!", ma

ktheu.

"Po, a?!", ia ktheva.

"Po, sepse unë që moti jam i fejuar!", foli me gjysmë zëri.

## DOJA TA HAJA TË GJALLË!

Në çast ia hodha një shikim të rreptë.

Seç më lindi një urrejtje aty për aty.

Doja ta kapja për flokësh dhe ta shkundja si batanijen kur e shkundim në ballkon.

Pasi u qetësova pak shkuam në kafenenë ku rrinim gjithnjë dhe biseduam gjerë e gjatë.

Por, bandilli tashmë e kishte marr vendimin.

Më shtrëngoi fort e fort për trupi dhe ma dha puthjen e parë, por edhe të fundit...

Kësaj vere bëhen 5 vjet nga ajo puthje, e që mua nuk më hiqet dot nga mendja... Pse?

Ishte puthje magjike, a?!


Sidoqoftë, para meje qëndron dilema: Si do gjej forcë t'i hidhem në krahë një tjetri?

**Vegimja, Xërxë**

# KENDA

CENTER

Trupi juaj e meriton këtë  
**AJENI GATI?**



**Rezervoni seancën tuaj të parë sot! +**

**DM ose na telefononi**



# ATY KU U TAKUAM - ATY EDHE U NDAMË!

*Kur më the: “Nesër eja te vendi ku jemi takuar për herë të parë”, atë ditë dita kaloi si me dhunë.*

*Natën nuk më zuri gjumi, kurse kur erdh mëngjesi, me zemrën që më rrihte pa masë, u nisa dhe m'u bë sikur udhëtova një shekull rrugë derisa u gjeta përball teje e syve tu...*

Eh, sa kohë ka kaluar pa u takuar më!  
Dhe, pas krejt asaj kohe sot të mbaj dhe një herë në përqafimin tim, teksa biseduam për shumëçka: për dëshirat tona që tash kanë mbetur veç ëndrra.  
Po në këtë vend dikur jemi takuar dhe i kemi thënë njëri-tjetrit se vetëm vdekja

mund të na ndajë.

Këtu jemi betuar se kemi me luftuar për dashurinë tonë, pavarësisht vështirësive që mund të paraqiten.

Në këtë vend jemi takuar herën e parë dhe shumë herë të tjera.

Po në këtë vend ka qenë edhe takimi i fundit...

## QANTE EDHE DIELLI NË NDARJEN TONË!

Eh, qe edhe një herë u takuam në atë vend, por këtë herë më ndryshe se herëve të tjera.

Lotët tanë i paraprijnë ndarjes, trishtimit që na ka kapluar. Nisa të mallkoj fatin. Ai ishte i pamëshirshëm dhe i çuditshëm.

Kishte vendosur ndarjen tonë.

Në ato çaste kërkoja që të përqaftuar të ngrihem i përtej kufijve të mundësisë sonë,

të shkojmë në amshim...

A thua, a e kanë dëgjuar dhe ndjerë atë ditë ndarjen tonë Zoti, dielli dhe engjëjt?  
Edhe ata do të kenë qarë!

Edhe ti e edhe unë e dimë se Zoti kishte dashur të takohemi edhe një herë, që ta kuptojmë se sa shumë jemi dashuruar, edhe pse që të dy e dinim se ai nuk ishte tjetër veç takimi i ndarjes te bliri i kujti-meve tona...

## ATY KU U TAKUAM - ATY EDHE U NDAMË

Te bliri jemi takuar shumë herë dhe vetëm ai vend e di sa shumë jemi dashur unë e ti dhe po në atë vend edhe u ndamë për përgjithmonë, duke i premtuar njëri-tjetrit se kurrë nuk do të lejojmë që dashuria të zbehet, ani pse nuk do jemi bashkë kurrë...

**S. M.**



Lidhjet e plasaritura...

# A tradhtojnë të gjitha femrat?

*Pse ju shkel ajo juve?*

*Tradhtia në marrëdhënie është gjëja më e dhimbshme që mund t'i shkaktojë dikush personit me të cilin është në lidhje. Jo vetëm që u dëmton egon, por mund t'i bëjë edhe të pasigurt në veten e tyre...*

Edhe pse dashuria dhe kënaqësia në një marrëdhënie nuk janë attribute të caktuara, megjithatë zakonisht tradhtia rezulton nga një pakënaqësi. Nuk ka justifikime për tradhti, edhe pse shumica e meshkujve thonë se "ne kemi gjene poligame", gjë që në ditët e sotme vërehet edhe te femrat.

Ndoshta kështu mendoni edhe ju.

Nëse ju nuk dëshironi të jeni "i tradhtuari", atëherë kushtojuni rëndësi këtyre gjërave:

\* Kushtoji rëndësi detajeve, në veçanti pamjes së saj. Mos harro komplimentet, bëhu pak romantik.

\* Kur është fjala për seks, mos i bë gjërat rutinore, bëj diçka ndryshe, të veçantë, të mrekullueshme dhe mahnitëse.

\* Bëhu i ndershëm, i sinqertë, komunikues dhe i vëmendshëm kur ajo bisedon me ju.

\* Nëse në fillim ishe i mirë, vazhdo të mbetesh i tillë, mos u bë dembel dhe i pa interesuar për gjërat e përbashkëta.

\* Ji i pranishëm dhe i përkushtuar, fito besimin e saj.

**NUK JANË TË GJITHA FEMRAT TRADHTARE...**

Ekzistojnë disa femra që mendojnë se "të gjithë meshkujt janë të këqij", por ka të tjera që mendojnë ndryshe dhe janë të gatshme për një lidhje të mirë.

Të tilla mund të takosh kudo.

Nëse keni takuar njërin nga ato që ia vlen ta keni në krahë, mos hezito.

Pa dyshim, ka të tillë që tradhtojnë njëri - tjetrin, por nëse ju dëshironi të keni një marrëdhënie monogame dhe të begatë, atëherë bëni çmos të mbani lidhjen tuaj të "pastër" dhe të mrekullueshme, sepse nuk janë të gjitha feramat tradhtare, ka edhe të tilla që nuk luhaten në lidhjen e tyre.

Nga një kënd ndryshe

# Pse e kemi në shpirt inatin?!

*Çka do që bëjmë ne, shqiptarët, e bëjmë për inati, e jo për interes personal, familjar a kombëtar. Edhe kur udhëtojmë diku e bëjmë për inati të dikujt tjetër!*

*Në fakt, punët nuk ndryshojnë kurrë, sepse nuk jemi rastësisht kështu e këtu ku jemi...*



Ashtu sikur punojmë edhe i kemi punët. Tamam na vjen një gëzim që e kemi shtetin tonë dhe Serbia më nuk na rri me polici mbi kokë, posa të zgjohemi në mëngjes gëzimin na e varrosë gjendja politike: moszgjdhja e presidentit, pa Kuvend, pa qeveri stabile, e çka jo tjetër...

Pse tamam nis diçka – ndalet?! Se është kështu po e ilustruj me një shembull:

Po ecte një burrë me një thes me grurë në shpinë. Gjysmën e thesit e mbante në qafë e gjysmën në krah. E qonte në mulli ta bluante.

Teksa ecte, një burrë e pyet:

“Si je jaran, si po kalon?”

“Mirë jam, por jam lodhur me këtë jetë!”, ia kthen ai.

“E tillë është jeta, duhet durim! Ç’ti bësh?!”, i thotë ai.

“Vafsh në djall edhe ti me gjithë këtë muhabet! A po e sheh ç’kam në qafë?!”, ia kthen.

Andaj, edhe ne, shqiptarët e Kosovës, jemi bërë si burri me thes në shpinë...

Jemi lodhur më...

## **E HABITSHME: ASGJË NUK LEXOJNË - TË GJITHË TË “DIJSHËM”!**

Zgjohem në mëngjes, pi kafe në njërin nga lokalet afër Redaksisë.

Në biseda të ndryshme, edhe pse pak-kush lexon, të gjithë dinë për politikë! Të gjithë të mençur!

Nisin t’i komentojnë debatet në studiot e televizioneve tona që i fryjnë zjarrit dhe njëri nga ta, teksa pimë kafe, thotë:

“Filan moderatori, që udhëheq debate televizive, është “shtic”, sepse i hasmëron analistët ndërmjet veti!”. Andaj, kur njeriu mendon paksa më thellë, pashmangshëm i thotë vetes: Nuk jemi rastësisht kështu e këtu ku jemi, por tërë kjo është produkt i punës sonë për vetveten. I kemi punët kështu si jemi vetë...

## **NË AMERIKË PËR INATI TË ISH-TË FEJUARIT!**

Po e jap në vazhdim një muhabet që e dëgjova teksa pija kafe në parkun e qytetit, teksa i tregonte një femër një femre tjetër, e që, me gjasë, e kishte prishur fejesën:

“Jam kah foli me një njeri në Amerikë. Jo që kam qejf me shkua atje, por do shkoj në Amerikë veç për inati të këtij që më la, sepse ma bëke “ty nuk të merr askush!”.

Dhe, nuk ka muhabet as bisedë ku nuk ceket inati. Askush nuk thotë se po e bën për interesin e vet, të kombit, e çka jo tjetër...

Kur e patën pyetur një burrë të komunës së Lipjanit pse i ke bërë 26 fëmijë, ai tha: “I bëra për inati të një burri nga Bardhoshi, se ai ka pasur më shumë se unë!”.

## **ÇDO GJË PËR INATI TË TJETRIT...**

Kishin qenë ty vëllezër dhe kur zgjoheshin në mëngjes uleshin pranë oxhakut.

Instinktivisht i madhi luante me hirin e oxhakut.

E rrafshonte hirin me shuplakën e dorës.

Pasi e rrafshonte merrte një krande dhe bënte vija. Vëllai i vogël ofron kokën të shihte çka bënte më i vjetri dhe e pyet:

“Çka po bën?”.

“Po e bëj planin e shtëpisë që do e ndërtojmë”.

“Jo tybe, s’kemi me e bë kështu kurrë, por qysh them unë!”

Dhe, e rrafshonte hirin me shuplakë dore dhe fillonte të bënte vija...


“Ti nuk ke lidhje me shtëpi, prandaj kështu nuk mund ta bësh kurrë!”, ia kthente i madhi.

Kështu, fjalë pas fjale e qonin ditën, e në mbrëmje i thonë njëri-tjetrit: “Të flemë se për sot boll punuam...”

**S. Rama**



**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP



@dentfix ks


+383 44 22 55 34

[www.dentfix-ks.com](http://www.dentfix-ks.com)

Ahmet Krasniqi Str. No 137,  
Pristina, Kosovo



**CARE & HAIR FIX**  
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



**CARE & HAIR FIX**  
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC

# KOSOVIA RJA

## JETLIRA ZYFI

la Zvicrën për të ngritur  
“Medical Hills”,  
perandorinë e estetikës  
dhe bukurisë në Shqipëri





# CIMA GRAND COMPLEX

PRISHTINA E RE

JETO LUKSIN NË ZEMËR  
TË PRISHTINËS SË RE.

CIMA GRAN COMPLEX

+383 49 50 90 90  
[www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)

Të lësh pas një jetë të ndërtuar në një nga vendet më të zhvilluara të Evropës dhe të nisish gjithçka nga e para në trojet shqiptare, kërkon guxim, vizion dhe një besim të palëkundur te vetja. Kjo është historia e Jetlira Zyfit, një gruaje që pas 26 vjetësh jete në Zvicër vendosi të rikthehej në Shqipëri për të ndërtuar jo vetëm një biznes, por një histori frymëzuese suksesi.

Sot ajo drejton “Medical Hills”, një nga qendrat më të njohura të estetikës në Shqipëri, ndërsa së bashku me bashkëshortin e saj ka ngritur edhe disa sipërmarrje të tjera.

Në këtë intervistë Jetlira rrëfen sfidat e rikthimit, sakrificat personale, filozofinë e saj të punës dhe besimin e madh që ka te potenciali i shqiptarëve për të ndërtuar të ardhmen në vendin e tyre...

**Jetlira Zyfi** la Zvicrën për të ngritur **“Medical Hills”**, perandorinë e estetikës dhe bukurisë në Shqipëri

## E faqes së parë

**Jetlirë, jeni e lindur dhe e rritur në Zvicër. Keni jetuar 26 vjet atje. Çfarë u shtyri të lini një jetë të ndërtuar atje dhe të riktheheni në trojet shqiptare për të ndërtuar diçka nga e para?**

- Në radhë të parë, dashuria...

Pas 26 vjetësh jetë relativisht monotone në Zvicër, fillova të reflektoj më thellë mbi atë që dëshiroja realisht nga jeta.

E kuptova se kërkoja një lidhje më të fortë me rrënjët e mia.

Si shqiptare ndjeva se vitet e mia më të mira nuk doja t'i kaloja duke kontribuar vetëm për një vend të huaj, por doja t'i investoja në vendin tim.

Së bashku me bashkëshortin kishim vizione të qarta dhe një dëshirë të fortë për të dhënë kontributin tonë në zhvillimin e Shqipërisë. Rikthimi nuk ishte i lehtë, por ishte një vendim i ndërgjegjshëm për të ndërtuar diçka me vlerë dhe për t'u bërë pjesë e ndryshimit që dëshironim të shihnim.

Pikërisht, kështu lindi ideja për të krijuar një klinikë estetike me standarde të larta evropiane...

**Rikthimi nga diaspora në vendlindje shpesh shihet si sfidë. Sa e vështirë ishte për ju të transformonit një vizion personal në një realitet biznesi në Shqipëri?**

- Ishte shumë e vështirë. U gjenda në një vend që ishte, njëkohësisht, i njohur dhe i panjohur për mua.

Nuk e zotëroja mirë gjuhën, nuk kisha një rreth të konsoliduar shoqëror apo familjar dhe nuk kishim kapital të madh për të nisur.

Ishim vetëm unë dhe bashkëshorti im në Tiranë, duke filluar gjithçka nga zero. Por, pikërisht këto vështirësi na forcuan dhe na bënë më të vendosur.

**Sot, pas pesë vjetësh, një pjesë e madhe e klienteles suaj vjen nga diaspora dhe turistët. Çfarë mendoni se i bën shërbimet tuaja shumë të kërkuara?**

- Shqipëria dhe Kosova janë bërë gjithnjë e më të njohura për shërbimet estetike. Ne kemi arritur të konkurrojmë me tregje të mëdha edhe falë kostove më të favorshme, por mbi të gjitha falë cilësisë. Sot rreth 70 për qind e klientëve tanë vijnë nga diaspora dhe turizmi mjekësor. Ata nuk zgjedhin vetëm çmimin, por edhe profesionalizmin, sigurinë dhe rezultatet. Në trojet shqiptare kemi mjekë shumë të aftë, të trajnuar dhe me përvojë, gjë që e bën produktin final jashtëzakonisht konkurrues në nivel ndërkombëtar.

**Si pronare e "Medical Hills", cili ka qenë momenti kur kuptuat se projekti juaj po shndërrohej në një histori suksesi?**

- Momenti vendimtar ishte kur investimi në marketing filloi të ulej, ndërsa klientela vazhdonte të rritej.

Atëherë kuptova se "Medical Hills" kishte hyrë në një fazë tjetër. Klienti u bë "influ-

enceri" ynë më i mirë.

Rekomandimet, besimi dhe fjala e mirë nga goja në gojë janë treguesit më të fortë se po ndërton diçka të qëndrueshme...

**Ju drejtoni jo vetëm një klinikë të njohur, por edhe disa biznese të tjera së bashku me bashkëshortin. Si ndërtohet balanca ndërmjet partneritetit në jetë dhe partneritetit në biznes?**

- Kërkon një ndarje të qartë ndërmjet jetës profesionale dhe asaj private, edhe pse kjo nuk është gjithmonë e lehtë.

Në biznes një femër duhet të jetë shpesh me energjinë e mashkullit: të jetë shumë e fokusuar, vendimmarrëse dhe e fortë.

E, në familje ka mundësinë të jetë thjesht feminine, vetvetja, bashkëshorte dhe nënë.

Bashkëshorti im e kupton këtë ekuilibër dhe pikërisht aty qëndron forca e partneritetit tonë...

**Sa ka pasur ndikim formimi dhe kultura zvicerane në mënyrën se si i menaxhoni ekipet dhe bizneset?**

- Shumë. Zvicra ka një nga kulturat më të forta të disiplinës dhe etikës së punës në botë. Aty kam mësuar strukturën, profesionalizmin, komunikimin korrekt dhe rëndësinë e përgjegjshmërisë. Ndonjëherë kolegët më thonë me humor se e marrë punën tepër seriozisht, por pikërisht ky standard më ka ndihmuar të arrij rezultatet që kam sot.





### **Në një industri si estetika, ku besimi është gjithçka, si arrini të ndërtoni marrëdhënie afatgjatë me klientët?**

- Gjithçka nis nga organizimi dhe kujdesi ndaj klientit. Ne kemi ndërtuar një databazë digjitale me mbi 5000 klientë të regjistruar, gjë që na ndihmon të mbajmë komunikim të vazhdueshëm dhe të kuptojmë më mirë nevojat e tyre. Kur klienti ndjen se po dëgjohej dhe vlerësohet, atëherë lind besimi. Dhe, besimi është themeli i çdo marrëdhënieje afatgjatë...

### **Shumë gra ëndërojnë të krijojnë diçka të madhe, por hezitojnë të bëjnë hapin e parë. Ç'do t'u thoshit?**

- Të fillojnë sot. Momenti perfekt nuk vjen kurrë. Gjithashtu, do t'u thosha ta marrin seriozisht pavarësinë e tyre financiare. Vetëbesimi dhe liria për të zgjedhur vijnë edhe nga stabiliteti ekonomik...

### **Sa sakrificë ka pasur rrugëtimi juaj personal dhe profesional?**

- Shumë. Për të arritur këtu ku jam sot, më është dashur të lë pas versionin e vjetër të vetes. Kam kaluar zhgënjime, kam parë njerëz të largohen dhe marrëdhënie të ndryshojnë. Por, në vend që këto situata të më ndalnin, i kam kthyer në motivim për të ecur përpara. Në të njëjtën kohë, gjatë këtyre viteve, jam bërë edhe nënë e dy fëmijëve. Kjo më ka dhënë një forcë të jashtëzakonshme dhe më ka bërë edhe më të vendosur si grua dhe sipërmarrëse...

### **Nëse ktheheni pas, si vajzë e rritur në Zvicër që vendosi të rikthehej në**

### **Shqipëri, çfarë do thoshit sot?**

- Do të thosha se ishte vendimi më i mirë i jetës sime; Se gjithmonë kam ditur të përballem vetë me sfidat; Se rruga do më çojë drejt njerëzve të duhur dhe mundësive që do e ndryshojnë jetën time.

### **Në pesë vjetët e fundit ju dhe bashkëshorti juaj keni ndërtuar disa kompani të suksesshme. Cili ka qenë sekretit?**

- Nuk ka sekret. Ka vetëm shumë punë, përkushtim dhe këmbëngulje. Të qëndrosh i bashkuar, të mos humbasësh fokusin dhe të mos harrosh kurrë vizionin që ke vendosur që në fillim...

### **A mendoni se diaspora shqiptare mund të luajë rol vendimtar në zhvillimin ekonomik të vendit?**

- Absolutisht, po. Madje, mendoj se tani është momenti ideal. Shqiptarët që jetojnë jashtë kanë fituar përvojë, njohuri dhe kapital. Nëse këto burime rikthehen në vendlindje, ndikimi mund të jetë transformues për ekonominë dhe sipërmarrjen shqiptare.

### **Estetika sot lidhet gjithnjë e më shumë me vetëbesimin. Si e shihni këtë transformim?**

- Nuk mendoj se vetëbesimi duhet të mbështetet vetëm te pamja e jashtme. Por, nëse një përmirësim i vogël estetik e ndihmon një person të ndihet më mirë me veten, atëherë kjo është diçka pozitive. Sot njerëzit kërkojnë rezultate natyrale dhe përmirësime të balancuara, jo transformime ekstreme. Në shumë raste

kemi ndihmuar të rinj që kanë vuajtur nga bullizmi për shkak të një tipari fizik. Kur një ndërhyrje e vogël mund t'u ndihmojë të rifitojnë vetëbesimin, kjo është një nga kënaqësitë më të mëdha të profesionit tonë.

### **Cili është vizioni juaj për "Medical Hills" dhe bizneset e tjera në vitet e ardhshme?**

- Jemi të fokusuar te inovacioni, ndërtimi i një marke të fortë dhe krijimi i sistemeve që mund të rriten pa humbur cilësinë. Objektivi ynë është rritja e qëndrueshme, forcimi i pozicionit në treg dhe zgjerimi i mëtejshëm përmes profesionalizmit dhe rezultateve të matshme.

### **Nëse do ta përshkruanit historinë tuaj me një fjalë, cili do të ishte mesazhi juaj?**

- Rrugëtimi drejt suksesit është i mbushur me sfida, pengesa dhe humbje, por fokusi duhet të mbetet gjithmonë te zgjidhja dhe jo te problemi. Kur ke vizion, punon shumë dhe nuk dorëzohesh, gjithmonë gjen rrugën për të ecur përpara...

### **Në vend të përfundimit...**

Historia e Jetlira Zyfit është më shumë sesa historia e një sipërmarrëseje të suksesshme. Është historia e një vajze shqiptare që u rrit në Zvicër, por zgjodhi të investojë energjinë, dijen dhe ëndrrat e saj në vendin e origjinës. Një dëshmi se kur vizioni bashkohet me punën e palodhur, kufijtë gjeografikë humbasin rëndësinë dhe sukcesi bëhet vetëm çështje kohe...

**Nderim Neziri**



# Si para 100 vjetësh - si tash: Mjerë vatani, mjerë mileti!

*Kudo në botë politikanët e partive të ndryshme bashkëpunojnë kur është në interes të shtetit dhe këtu nuk ka asgjë të keqe.*

*Por, a ndodh kjo edhe te ne, në Kosovë?*

Në Kosovë politikanët tanë e mbrojnë me mish e shpirt interesin e vet, pastaj atë partiak, të cilin na e shesin si interes kombëtar!

E, nëse u mbetet kohë për ndonjë gjë tjetër, merren edhe me ndonjë interes të familjes, të mëhallës, të katundit a të anës prej kah kanë ardhur...

Ky ilustrim u rri më së miri politikaneve tanë, të cilët, me gjasë, janë të vetmit politikanë në botë që e kanë në shpirt se nuk ka bir nëne që i ndërrojnë nga vendet që i kanë, thuajse i kanë me tapi!

Dhe, duke e shfrytëzuar këtë maksimum, politikanët tanë i hapin

krahët dhe japin deklarata nga ma të ndryshmet, duke e ngritur veten në pedestal.

Andaj, fjalët "Mjerë vatani, mjerë mileti" i shkojnë përshtati kohës në të cilën jetojmë...

## CILAT KATUNDE TË PRISHTINËS DO TË ZHDUKEN SË SHPEJTI?

Disa katunde të komunës së Prishtinës që nga paslufta janë me pak njerëz, për të mos thënë të boshatisur plotësisht.

Disa katunde, si, bie fjala, Mareci, Hajkobilla, Radasheci, Gillogovica, Prapashtica etj., më shumë komentohen si vende se dikur kishte banorë në to sesa si vende se në to banon ndokush...

Sepse, të gjitha familjet që jetojnë në këto fshatra, po të tubohen në një vend, nuk bëjnë sa një lagje e dikurshme e cilitdo fshat që e përmendëm...

## KURRË S'KA ME U BË MIRË!

Del paksa qesharake kur thuhet se kurrë s'ka me u bë mirë, por këto fjalë i dëgjova ditë më parë nga një udhëtar në autobusin nr. 4, i cili qarkullon në relacionin Gërmi-Matiçan.

I moshuari, i cili ishte ulur përballë meje, pas fjalëve që ndërruam ndërmjet veti, pashë se ishte i mllefosur me gjendjen aktuale politike te ne ku një parti thotë se do ta zgjedhim me kohë presidentin e Kosovës e tjetra thotë s'jemi askund...

Unë, që t'i jepja pak vullnet për jetë në pleqërinë që e kishte, i thashë: "Mirë e bën Zoti!"

"Pasha një allah, që ma ka dhënë shpirtin, kurrë s'ka me u bë mirë!", ma ktheu me shumë nervozë.

"Eu, ç'më zuri taksirati?!", e solla në mendje dhe në stacionin e parë zbrita nga autobusi, vetëm e vetëm që të qetësohesha pak...



# 27 VJET PAS LUFTE, HË, ÇKA?!

*Çuditërisht, gjatë këtyre viteve, kryesisht, pjesa dërmuese e popullit ka heshtur, ka pritur realizimin e ëndrrave të shumta, ditë të mira në liri, në mes njëri – tjetrit më shumë dashuri, solidaritet, por edhe pak jetë, që, s'paku, të mos i shkojë mendja dikujt të ikë nga Kosova...*

Çuditërisht, them prapë, populli im ka lejuar që shtetin e ardhshëm ta definojnë ekstremistët dhe profiterët politikë!

Ka lejuar që në kokë t'na hipin politikanë anal-fabetë, ministra diletantë, e që pushtetin e kanë shfrytëzuar për të rritur pasuritë e tyre dhe për të punësuar farefisën e pashkollë!

Ka lejuar që themelet e pavarësisë së shumëkërkuar të na i ndotin tenderët, korrupsioni, trafikimi, kontrabanda!

Ka heshtur populli!

Ka duruar Kosova!

E, tash, është momenti që populli të mos heshtë më!

\*

Bota i ka mbi tetë miliardë banorë.

Dhe, dola unë të jem shqiptar, njëri nga miliona shqiptarët në këtë rruzull tokësor.

Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja të them

pse u linda shqiptar, madje as atëherë kur ishim nën robëri, as në pamundësitë për realizimin e shumë ëndrrave...

Aq më mirë, madje, që jetova në robëri, që t'ia dija shumë më shumë vlerën lirisë.

Por, njeriut i takon të ketë edhe të tjera ëndrra, si ndërtimi i shtetit me të gjitha të mirat e mundshme: shkollimin, punësimin, lirinë, demokracinë... Mirëpo, disa synime mbetën edhe sot ëndrra... Gjithmonë e kam arsyetuar veten me thënien: hajt se bëhet mirë... hajt se vjen edhe ajo ditë kur mund t'i realizoj dëshirat...

Por, ja që, ani pse po frymoj në Kosovën time të lirë, nuk po e shoh atë Kosovën time të ëndrrave...

Shoh shumë njerëz me halle, të brengosur, të zhgënjyer, por edhe me lot për të siguruar kafshatën e gojës!  
Keq!

**Gani DILLI**

## KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILLI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILLI

**Redaksia:**

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu Bajoku

**Dizajni:**

Labinot Bërbatovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)

Shumë e rrallë...



# Cila familje shqiptare i ka 500 anëtarë e t'fiu?

*Në mesin e më se 10 mijë shqiptarëve nga Lugina e Preshevës në Zvicër, janë edhe familja Seferi, nga Presheva. Ata janë atje që afro 60 vjet.*

Mjafton të përmendet Mustafë Demiri, i cili i pari qeli "meqaven" e kurbetit. Ai fillimisht erdhi vetë, e më vonë, si lokomotiva që tërheqë vagonët, tërhoqi edhe vëllezërit e tij një nga një: Hysenin, Milaimin, Fehmiun (i ndjerë).

Mustafa, "lokomotiva" e familjes Demiri nga Presheva në Lusanë, e që atje jeton nga viti 1968, asnjëherë nuk e ka hequr plisin dhe e mban me krenari.

Ata janë krenarë që jetojnë në Zvicër, sepse u kanë kontribuar së pari familjeve të tyre në Preshevë, e pastaj edhe vendit në mënyra të ndryshme, përmes një sërë aksionesh humanitare. "Nuk është mirë me e lënë vendin, atdheun, por nganjëherë koha dhe kushtet ta imponojnë deshe a s'deshe dhe këtu s'kemi ardhur për qejf, por me puna e fitua dhe një ditë të kthemi kah kemi ardhur, se vendi i huaj nuk

bëhet i yti", pat thënë para një kohe Mustafë Demiri.

Çdo vit familja Demiri, nga Karadaku Seferi në Preshevë, e që jetojnë e vepron në Lusanë të Zvicrës, tubohen, mbajnë mbledhje, organizojnë kuvendin e tyre vjetor...

Numri i anëtarëve të familjes së tyre tashmë e ka kaluar që moti numrin 500 e t'fiu... Mrekulli, a?

# A do ta ketë Kosova më një Sefë Mleçan?

*Dikur kanë qenë një familje këngëtarësh, nën krahun e të papërsëritshmit Sefë Mleçani (1918-1975).*

*Edhe tani janë të gjithë këngëtarë me nam, megjithëse tre djem të Sefës nuk janë më.*

*Imeri, Osmani dhe Brahimi janë ata që trashëgojnë traditën. Ata, jo vetëm që janë këngëtarë të njohur dhe njihen si "Bijtë e Sefës", e që ftohën në dasma e ahengje, por ende veprojnë si tre trupa me një zë.*

*Ata nuk mund t'i imitojë askush dhe ende janë në formë të ndezin ndejën e adhuruesve të vet.*

*Sefa dhe bijtë e Sefës, thjesht, janë të papërsëritshëm...*



## ÇKA E KA BËRË SEFË MLEÇANIN TË MADH?

Një rigë shiu lag lapidarin e dy dëshmorëve në hyrje të fshatit Mleçan, të komunës së Malishevës, në ditën që e vizitua familjen Mleçani në vitin 2011. Familja e Sefë Mleçanit i kanë dhënë shumë Kosovës: Tre djem të rënë për Kosovë, një vuajtje për vajzën dhe katër palë përkuajdesje për jetimët e tyre, si dhe një shtëpi meshkuj të papërsëritshëm për këngë sharkie, të cilët e mbajtën gjallë jetën patriotike kundër Serbisë.

Në pasditen e së shtunës që i vizitua, oda e shtëpisë së Mleçanëve kumbonte nga kënga e tre djemve të një zëri: Imerit, Osmanit dhe Brahimit, të cilët sa herë tubohen bashkë, aty ku edhe i ruajnë muret e kullës së gurit të babës Sefë, këndojnë këngët e traditës së kësaj shtëpie, që nga gjyshi Ibrahim Gashi.

Shtëpia e trashëgimisë së rapsodit të madh, Sefë Mleçani, ka pasur fatin e hidhur edhe në historinë e luftës së viteve 1998-1999. Ajo ia mori dy djem: Beqirin dhe Ismetin.

I pari trashëgimtar i Sefës thuhet se ishte unikat, bashkë me Ismetin e rënë, ndërsa Xhaferi është vrarë në rrethana misterioze me të mbaruar ushtrinë, kur po e vuante burgun ushtarak në Idrizovë të Maqedonisë.

## SEFA KËNDONTE ME ORË TË TËRA...

Sefë Mleçani, i njohur në popull si Sefë Brahimi, ishte njeriu që vuajti shumë. Pavarësisht se i kishte kryer vetëm katër vjet shkollë në gjuhën serbe, jeta e bëri të ndjeshëm dhe të shkathtë të manovrës me tekste këngësh pa mbajtur shënime, falë mbamendjes dhe talentit. Jeta e kishte bërë t'i përngjante Zef Serembes, që vargjet t'i ruante vetëm në kokë.

Ishte i jashtëzakonshëm dhe ndër të vetmit rapsodë i cili këndonte pa tekst para vetes, madje pa e ngatërruar asnjë rresht!

"Baba kishte jetë tepër të vuajtur dhe jeta e tillë e bëri t'i mbante në mend këngët. Ishte mishëruar me këngët në stilin "Kënga është vaji i burrit"! Baba Sefë këndonte si askush tjetër", shpjegon Imer Sefë Mleçani, djali i madh i Sefës, shoku i parë i babës në odën e këndimit para burrave, qyshkur ishte shtatë vjeç.

Ai, duke përshkruar momente të jetës

me babë Sefën, në mes Osmanit dhe Brahimit, thotë:

"Baba ishte i vetmi mashkull në shtëpinë e tij. Nuk kishte vëlla e as motër. E kishin fejuar, por pak ditë para martesës i kishte vdekur e fejuara. E, baba i të fejuarës së vdekur vendosi t'ia jepte vajzën e vogël, katërmbëdhjetë vjeçe, Sadberen.

Ajo, në atë moshë, u bë gruaja e Sefës. Në natën që martoheshin, baba ishte lutur me dy reqate: "Zot, falmi 9 djem: 6 të jetonin, tre të vdisnin në luftëra!". Ishte disi si profet, sepse ashtu qysh kërkoi edhe ndodhi...

Baba arriti ta mbushte shtëpinë djem. I bëri me nënën 9 djem e dy vajza. Dy djem vdiqën qysh herët në moshën katër e pesëvjeçare, ndërsa shtatë u rritën dhe u bënë burra, bashkë me dy motra.

Njëri u vra në rrethana misterioze në burgun ushtarak të Jugosllavisë dhe dy djem ranë në luftë si ushtarë të UÇK-së", tregon këtë kapitull jete të dhimbshme Imer Mleçani, djali i madh i rapsodit Sefë Mleçani në odën e tij në Mleçan.

## U PËRMBUSH AMANETI I SEFËS...

"Kur u vranë Beqa dhe Ismeti, u thosha vëllezërve mos ta marrim shumë tragjike, sepse edhe lutja e babës në natën e martesës ishte siç kishte kërkuar, prandaj amaneti i tij përmbush.

Baba ishte i aftë që aty për aty të formulojë vargje nën tingujt e sharkisë, për t'i argëtuar dashamirët e vet, që e përcillnin kudo që shkonte", thonë Osmani dhe Imeri në prani të Brahimit, i cili i dëgjon rrëfimet për vuajtjet e babës, pa llogaritur edhe atë kur Sefë Mleçani ishte ndarë nga UDB-a për transferim në Tivar, ku u vranë mijëra shqiptarë. Babën e kishte shpëtuar një njeri që e kishte hequr nga rreshti me kërkesën e kamufluar se ky i duhej Kosovës...

Imeri dhe Osmani këngët i mësuan nga babai.

Dhe, në odën e tyre, teksa tregojnë si i kanë mësuar këngët, lidhur me këtë, thonë:

"Nuk ishte problem t'i mësonim këngët, por s'kishim instrumente. Mësuam që nga trangu i tallës së misrit ta bënim çiftelinë. Pjesën e tallës e gdhendnim në formë çiftelie dhe nga ajo nxirrim tinguj.

Në skamje mësuam ta imitonim babën aq sa dinim dhe t'i mësonim këngët. Ai ende këndonte i vetëm, pa u shoqëruar

nga askush dhe ishte një krijesë unike që nuk mund të mbulohej me dikë tjetër as nga zëri, as nga fuqia e këndimit me orë të tëra pa u ndalur. U bë më i kërkuari në oda dhe dasma, u bë i pazëvendësueshëm për këndimin e këngëve të ciklit të kreshnikëve dhe të trimërisë, por edhe të zhanreve të tjera. Mua më merrte në oda e dasma që nga mosha shtatë vjeç. Më bëri shokun e parë, me të cilin i këndonte këngët", tregon Imeri dhe vazhdon tregimin: "Duke më bërë shok të këngës, ai e lehtësoi vetveten, sepse u bëra krah i tij. Më vonë në ndihmë na erdhi edhe Osmani...

Dhe, kur u bëmë tre vetë (babë Sefa me dy djem), u bëmë ekip dhe një zë i për-bashkët, kurse puna u bë më e lehtë... Andaj, ku ishim ne, të tretë, kumbonte oda në dasma e ndeja rasti, e që ishin të përditshme...

Më vonë na u bashkëngjiti edhe Brahimi, i cili kreu shkollën e muzikës dhe ishte i shkëlqyer, e që i dha fuqi tërë procesit të këngës në shtëpinë tonë", përfundon Imeri këtë pjesë të përjetimeve me babën Sefë Mleçanin.

## PSE I PËRCILLTE UDB-a SEFË MLEÇANIN DHE TË BIJTË E TIJ?

Sefë Mleçani me të bijtë ka luajtur rol të jashtëzakonshëm në krijimin e patriotizmit te brezi i ri. Aty merrej frymëzimi i parë i gjeneratave të reja, me motivimin se liria e Kosovës vjen vetëm përmes luftës me Serbinë.

Për këtë qëllim, ata, në shumë dasma, janë përcjellë nga UDB-a. Por, Sefë Mleçanin me të bijtë i ka ruajtur publiku, që të mos bien në kurth të pushtetit.

Kanë kënduar pa censurë vetëm kur u është thënë "oda është e juaja"! Këngët kreshnike kundër kralëve serbë gjithmonë kanë qenë ato që e kanë ndezur fitilin ndëretnik serbo-shqiptar dhe nuk ka këngë e këtij cikli që nuk e ka një porosi, kur ato i dëgjon në cilëndo mënyrë.

Dhe, duke folur për ekipin muzikor të rapsodëve, Imer Sefë Mleçani thotë se si djali i parë i Sefës ishte adhures i madh i këngëve dhe mburrej me babën që vuri themelin e dashurisë ndaj këngëve folklorike në shtëpi.

"Ka qenë zor me e ndjekë babën në këndim. Ai ka kënduar 24 orë pa u ndalur.

Baba nuk ka ditur të pushojë...

Shumë këngëtarë kanë pushuar ndër-

mjet këngëve, ose duke e zëvendësuar zërin me telat e sharkisë.

Baba kur u hynte këndimit të këngëve të Mujit e Halilit, nuk ndalej deri në fund dhe ato këngë, siç dihet, nuk kanë zgjatur një orë, por disa orë rresht. Babë Sefa nuk ka bërë hile në këndim, por ka bërë histori burrërore kudo që ka shkuar...

Kur i këndonte këngët e Mujit e Halilit, më duket edhe tash sikur e shoh kah e përjetonte historinë, sepse ishte i pasionuar në rrugën e këtij misioni, ku kënga kishte mesazh e porosi për gjeneratat e reja.

Nuk belbëzonte asnjëherë, sado të gjata të ishin tekstet e këngëve...

Ne nuk dimë që baba t'i ketë lexuar në letër ndonjëherë tekstet e këngëve që i ka kënduar...

Nuk dimë si i ka formuar ato dhe nuk dimë si i ka mësuar, por dimë se gjithmonë i ka kënduar njëjtë, pa e ndryshuar asnjë fjalë...

Dhe, kur e ke dëgjuar qoftë edhe për të njëqindtën herë cilëndo këngë të tij, ajo ka qenë e kënduar si herën e parë, pa u ndryshuar asnjë fjalë dhe pa e ndryshuar as tonin e këngës.

Pra, kishte aftësi të madhe për t'i mbajtur mend këngët. Ka qenë arkiv në mbamendje të këngëve...

Edhe ne, tash, kur këndojmë, i kemi po ato këngë, po ato tekste dhe po atë ton këndimi...

Kur kam filluar të këndoja me babën, i kam pasur shtatë vjet, e baba ishte rreth të tridhjetave. Kemi kënduar së bashku deri në vitin 1973.

Në atë kohë, babës i ra hise ndërrimi i shokut, sepse ashtu erdhën rrethanat. Me babën u bë shok Osmani, që kishte zë të fortë ashtu sikur e ka edhe sot...

Dhe, jo vetëm zë të fortë, por edhe shumë të thekshëm e melodik.

Por, ai që përshtatej më së miri me babën ishte Brahimi, e pak më vonë edhe Beqiri, që i tejkaloi të gjithë, duke u bërë enciklopedi muzikore në oda.

E, kur u bëmë shumë vetë në grup, më nuk ishte brengë këndimi, por UDB-a. Ata na përcillnin përmes spiunëve të vet nëpër dasma...

Dhe, kur kishte elementë të tillë në oda, zakonisht, na e bënë me dije se duhej ta censuronim veten nga këndimi...

Në atë kohë filluan edhe arrestimet e shqiptarëve për mendim ndryshe, nga ç'ishte deri atëherë...

Dhe, karshi popullaritetit që bëmë në masë, nuk ishte e lehtë t'i rezistonim presionit të UDB-së, sepse kishte raste

kur publiku e dasmorët donin këngë që kishin syzhe luftërat shqiptaro-serbe", thonë të bijtë e Sefës në odën e tyre.

## REZERVIMI BËHEJ GJASHTË MUAJ MË HERËT!

Se janë kërkuar shumë bijtë e Sefës në dasma, tregojnë kërkesat e shumta me regjistër.

Osmani dhe Imeri rikujtojnë detajet:

"Kemi pasur kërkesa të mëdha, të cilat mezi i kemi përmbushur. Kemi qenë të zënë deri në gjashtë muaj. Terminët i kemi ditur vetëm duke i shfletuar shënimet.

Kur kemi kënduar me babën, e di se çmimi ka qenë 20 qese dhe kanë pasur vlerë.

Orari ynë ka qenë nga e shtuna pasdite e deri të hënën pasdite. Ka qenë program i gjatë dhe i larmishëm", thonë ata.

E, duke folur për kujtimet më të mira në dasma me babën, ata thonë se kjo ka ndodhur në Dobërdol te katolikët dhe në Siqevë.

"Në Tërpezë, Novosellë e Kleçkë dinin ta përjetonin më së miri këngën. Sa kam ngrënë hallvë në ato vende, po të kishte qenë baltë, do t'i kisha lyer të gjitha kulat dhe shtëpitë tona", i kujtojnë fjalët e Sefës.

## NË DASMËN E HAMËZ SHABAN JASHARIT...

"Një dasmë shumë e veçantë ka ndodhur në konakun e Jasharajve në Prekaz, kur është martuar Hamëz Shaban Jashari, ku ka pasur aq shumë krisma rreth nesh, sa kishim frikë se mund të ndodhte më e keqja duke kënduar mes atyre plumbave", tregojnë të bijtë e Sefës.

Sidoqoftë, në familjen e Sefë Mleçanit nuk do të shuhet kënga, themelet e së cilës i vuri Sefa, vazhduar përmes Imerit, Osmanit, Brahimit, Beqirit dhe të tjerëve.

Ajo tash do të profilizohet nga nipërit e Sefë Mleçanit, disa prej të cilëve e vazhdojnë shkollimin në fakultete dhe në shkollat e muzikës.

## RAPSODI QË I KALONTE PROFESORËT E LETËRSISË POPULLORE

Rapsodi i madh popullor e folklorik, Sefë Mleçani, i ka shërbyer edhe Univer-

sitetit të Kosovës, Degës së Letërsisë, në lëndën e letërsisë popullore, duke bashkëpunuar me Prof. Dr. Shefqet Pllanën, i cili e çmonte shumë rapsodin më në zë të kohës, Sefën.

E, vetë Sefë Mleçani do të bëhej figurë e madhërisme e ligjëratave të këtij lëmi në Fakultetin Filozofik në Prishtinë...

Ai, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nxiste dhe edukonte ndjenjat e atdhedashurisë dhe patriotizmit, që reflektonin këngët e njohura, ku kishte gjak e histori nga marrëdhëniet shqiptaro-serbe.

Dhe, në kuadër të kohës me shumë probleme të natyrave politike, këngët e Sefë Mleçanit mbetën frymëzim për brezat që do t'i sillnin liri Kosovës.

Këngët e tij ishin një mjet i parapërgatitjes së revolucionit, që u shfaqë në Kosovë në vitet 1970-1981, kur edhe ndodhën shpërthimet gjithëpopullore për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavinë e atëherëshme. E, në këtë kontekst, ngritjen e vlerave patriotike e kishte mundësuar edhe familja e Sefë Mleçanit, përmes profesorit të nderuar të Fakultetit Filozofik, Shefqet Pllanës.

## BIJTË E SEFËS NË FESTIVALET E FOLKLORIT BURIMOR

Trashëgimtarët e Sefë Mleçanit, që kënduan me të, janë pjesëmarrës të shumë festivaleve të këngës folklorike në Kosovë dhe më gjerë.

Një problem ishte sfidë e kohës: T'i rezistonin rrymës politike që i godiste shqiptarët në Kosovë.

"Kishte probleme të merrnim pjesë në festivale, ku i organizonin pseudokulturalistët, sepse këndimi duhej të reduktohej në nivel të kërkesave të tyre.

E, ne nuk e bëmë një gjë të tillë. Kur kishte kërkesa të tilla nuk merrnim pjesë fare, sepse nuk do të ishim vetvetja në ato evenimente.

Kemi marrë shumë herë shpërblime, kudo që e kemi përfaqësuar Kosovën...

Qëllimi ynë i fundit ka qenë o të marrim pjesë me atë që disponojmë origjinal, o të mos marrim pjesë fare me improvizime!", thonë Osmani e Brahimi.

Sidoqoftë, bijtë e Sefës kanë trashëguar shumë autoritet falë babait të tyre, sepse e gjetën të gatshëm tërë bagazhin folklorik, të cilin e kishte gatuar i rralli Sefë Mleçani.

Sefë Mleçani vdiq në vitin 1975.

**Safet Krivaça**

# Pse kurrë nuk shkruhet për Ymer Shkrelin?

*Ymer Shkreli u lind më 1945 në Shkrel të Rugovës.*

*Shkollën fillore e kreu në Haxhaj të Rugovës, kurse Normalen e nisi në Pejë dhe e mbaroi në Prishtinë, ku edhe i vazhdoi studimet në Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës.*

Ymer Shkreli një kohë punoi mësimdhënës në shkollën fillore në Haxhaj të Rugovës, pastaj në shkollën "Faik Konica" në Prishtinë dhe në Shkollën e Mesme Bujqësore në Prishtinë; kurse nga viti 1968 deri më 1993 punoi në të përditshmen "Rilindja", në fillim gazetar e reporter i lirë, pastaj redaktor i faqeve të "Rilindjes për fëmijë". Në fillim të viteve 70 ishte kryetar i Rinisë Letrare të Kosovës dhe kryeredaktor i revistës letrare "Plejada", e cila qe ndaluar pas botimit të numrit të saj të gjashtë.

Ai një kohë ishte njëri ndër bashkëpunëtorët më aktivë dhe anëtar

i Redaksisë së revistës për humor e satirë "Thumbi".

Ymer Shkreli e ka provuar penën e tij pothuajse në të gjitha gjinitë dhe zhanret letrare.

Ka përkthyer dhe ka sjell në gjuhën shqipe një mori veprash të njohura të autorëve të huaj.

Ka botuar poezi dhe vepra për fëmijë, është autor i 13 romaneve: "Vjeshta e vdekur", në vazhdime në "Flaka e vëllazërimit", 1971, Shkup; "Njeriu në bisht", botoi "Rilindja", 1975, Prishtinë; "Vdekja në ajër të pastër", botoi "Rilindja", 1976, Prishtinë; "Bima e dreqit", botoi "Rilindja",

1981, Prishtinë; "Pikëpjekja", botoi "Rilindja", 1982, Prishtinë; "Rapsodi kosovare" (katër romane: "Kali i Trojës", "Heroi në gjumë", "Shpendkeqja", "Zeka i Zi"), botoi "Rilindja", 1986, Prishtinë; "Doracak për tjetër botë", botoi "Jeta e Re", nr. 4-5-6 /1986, Prishtinë; "Ura e xhehenemit", botoi "Rilindja", 1989, Prishtinë; "Azgal", botoi "Rilindja", 1993, Prishtinë, si dhe autor i mbi 20 dramave; i 13 radio-dramave etj.

Është shkrimtari më i vlerësuar me çmime letrare në Kosovë.

Nga viti 1993 jeton në Luzern të Zvicrës.

MË SHUMË SE NJË BANESË

*Një standard i ri jetese*



**DAAKONN**  
INVESTMENT



# Pse u ngrit në këmbë për mua plaku i Mirashit?

*Sillen mendimet e mia në dhomë. M'u kujtua një ngjarje në një odë të fshatit Mirash të Ferizajt. Ç'ndodhi atje?*

I kishte vdekur babai një moshatarit tim, që më quante dajë, por kurrë s'e kam ditur pse e kam dajë.

Babai më kishte vdekur moti, e unë kisha qenë i vogël ta pyesja pse e kishim dajë filanin e Mirashit që vinte në odën tonë.

U nisa të shkoja ta vizitoja dajën dhe kur arrita atje më thanë të hyja në odë. Më ulën kah fundi i odës, demek shkaku i moshës së re, por përballë një plaku. Pasi mbretëroi heshtja, u hapë biseda ngushëlluese.

Plaku, që e kishte pranë një kujdestar interpretimi, ofroi veshin afër tij dhe kujdestari i tregoi kush isha.

Plaku i dha të ngrihej, por të tjerët

reaguan, duke i thënë s'ka nevojë të ngrihej...

"Unë dua të shkoj te ai e jo ai të vjen te unë!", foli plaku.

Pasi u ngrit, ashtu i kërrusur, u afrua pranë meje dhe më mori ngrykë...

Diçka e madhe do ketë ndodhur që ai u ngritë e erdhi te unë, e solla në mendje...

"A i ke përngjarë babës?", më tha plaku posa u ulë afër meje. "Deri diku", i thashë. Pas këtij dialogu më tregoi se kishte qenë shok i idealit të babait tim, qyshkur kishin qenë ballistë në male dhe e kishin shkelur në këmbë Shqipërinë deri në Tivar.

Unë, për ta relaksuar situatën e krijuar,

që te të tjerët zgjoi interesim të madh ardhja ime në odë, i thashë:

"Unë mendova se vetëm pse jam i madh me trup të bëra përshtypje e u ngrite në këmbë për mua!

Por, po e tregoj një meselë: E pata gjetur një këlysh të vogël dhe e qova në shtëpi. Baba u qua nga vendi që ta shihte këlyshin. I thashë është i racës së mirë".

"Ky nuk bëhet qen i madh, sepse është pinok. Nuk na duhet qeni i vogël në oborr, sepse qenit të vogël askush nuk ia ka frikën, e të madhit po", më tha. E, unë mendova veç pse jam i madh me trup u ngrite në këmbë për mua...".

**S. K.**

*Ditë të vështira...*

# **Mos u bëfsh për doktor!**

*Mjeku, derisa të kontrollon, flet me tjetrin, e nuk e ka mendjen fare te ti...*

Stomatologu, pasi të ulë në “karrigen e frikës”, nis e flet me ndokënd në telefon.

E, edhe nëse e ke gojën plot shkumësa apo gjak, duhet ta mbash gojën hapur derisa ai e kryen bisedën me telefon... Kur fillon të punojë në dhëmbin tënd, ia kris muhabetit për politikë!

Se ndodhë kështu po e ilustruj me një shembull:

Para pak ditësh, derisa rrija ulur në karrigen e stomatologut me gojën hapur nga shkumësat, stomatologu nisi t'i shajë të tjerët e ta lavdëroj veten...

Dikur u mbusha vrer dhe i thashë: “Largomi shkumësat se më janë kapur për qiellze të gojës!”.

Pasi m'i nxori, i thashë:

“O dosti jem, prej kur jam këtu e ke ndal punën nja katër herë, duke folur me njerëz, e tash po bën lavd, a?! Po të ishe ti në rregull do e mbaje rendin në ordinancën tënde e nuk do veproje në këtë mënyrë!”.

“Kam shumë termine e nuk po di kah t'ia nis punës, rendit”, ma ktheu.

“Eh, ta tregon baca një mesele: Nastradin Hoxha kishte pasur shumë punë. Nuk i mbante në mend gjërat dhe, meqë i ishte zhvilluar harresa, i thotë gruas: “Më ndihmo, grua, ta kaloj harresën! Të premten e kam një punë. E, që të mos e harroj terminin merre këtë shkop dhe ma lë mbi tavolinë, në mënyrë që ta di se është e premtë”.

Gruaja një ditë lë shkopin mbi tavolinë dhe, me të hyrë Nastradini brenda, shkopi i përplasat në kokë.

Shpejt e shpejt i thotë gruas:

“Sot nuk është e premtë, grua, ç'dreqin e ke lënë këtu shkopin?!”.  
“Është nata e së premtës dhe u desh me e mbajt marrëveshjen”, ia ktheu ajo.

“Më dëgjo grua, nga sot në këtë shtëpi o shkopi o unë!”, i tha ai.

Kështu jeni bërë edhe ju mjekët, nuk po e dini kur është e premtë. Për shkop keni nevojë...”, i thashë me një qeshje, e që ishte më shumë ishte ironike.

**B. Bajrami**





# MARIGONA HILL

The fairytale is no longer a dream.  
It's home!





**MARIGONA**  
SUN

Meet the most exclusive  
way of living!



*Fatit s'i dihet...*

# Shqiptari i Shkupit - grua aktoren e famshme turke

*Aktorja e njohur turke, Ebru Ozkan, ka një lidhje shumë të veçantë me shqiptarët, jo vetëm për raportin nga ekrani, por ajo është e martuar me një shqiptar nga Shkupi, i cili që nga viti 2000 jeton në Turqi.*

Aktorja e njohur turke, Ebru Ozkan, e lindur në vitin 1978 në kryeqytetin e Turqisë, në Ankara, e njohur nga shqiptarët me rolin "Dilara" në serialin "Fate të kryqëzuara", ka shprehur vazhdimisht lidhjen e saj të ngushtë me shqiptarët.

Ajo është veçuar me rolin e saj prej zonje të vërtetë, siç edhe i ka hije, edhe me personazhin "Halidja", në njërin nga serialet më të pëlqyer në Turqi me titull "Zonja e çifligut".

Roli i fundit i Ebru Ozkanit është "Leyla Türk", në serialin "I paepuri". Sidoqoftë, aktorja e njohur turke Ebru Ozkan është martuar me Ertan Shabanin, shqiptar nga Shkupi, i cili, gjithashtu, është aktor i njohur në Turqi.

Çifti i famshëm i kinematografisë turke janë prindër të një vajze.

## **E, ERTAN SHABANI?**

Aktori Ertan Shabani, i lindur në vitin 1977 në Shkup, u shpërngul në Turqi në fillim të viteve 2000 dhe filloi aktrimin.

Deri më tash mori pjesë në dhjetëra seriale dhe prodhime të kinematografisë turke dhe renditet si njëri ndër aktorët më në zë.



**bashkëshortor Ebru Ozkan  
dhe Ertan Shabani**

# BOOM



**"Gjini Studio" në Gjakovë - kapitull i ri për industrinë e bukurisë në Kosovë**

Në Gjakovë është hapur një kapitull i ri për industrinë e bukurisë me inaugurimin e hapësirës së re “Gjini Studio”, një ambient modern, i rregulluar deri në detajet më të imta dhe i ndërtuar me një standard të lartë profesional.

Nën drejtimin e frizerit dhe makeup artistit të njohur Gjini Doda, studioja e re vjen me një staf të kualifikuar dhe një koncept të avancuar shërbimi, duke u shndërruar në një destinacion bukurie që mirëpret klientë jo vetëm nga Kosova, por edhe nga Shqipëria dhe diaspora.

Me këtë zgjerim, “Gjini Studio” forcon pozicionin si një nga studiot më të mëdha dhe më të rëndësishme në vend, duke ofruar një eksperiencë që ndërthur elegancën, profesionalizmin dhe kujdesin maksimal ndaj klientit.

Në këtë intervistë ekskluzive, Gjini Doda ndanë rrugëtimin e këtij zgjerimi, filozofinë e punës së tij dhe vizionin që e ka kthyer studioja “Gjini Studio” në një emër të besuar në industrinë e bukurisë.



## “Gjini Studio” në Gjakovë - kapitull i ri për industrinë e bukurisë në Kosovë

**Fillimisht, urime për zgjerimin e studios! Si lindi ideja për ta bërë këtë hap dhe çka u motivoi?**

- Ky zgjerim erdhi në momentin e duhur, si reflektim i rritjes dhe vizionit tim profesional.

Ishte një hap i natyrshëm që u krijua nga kërkesa në rritje dhe nga dëshira për të ofruar një standard më të lartë shërbimi.

**Nga studioja e mëparshme e deri te ky ambient i ri, i madh dhe shumë luksoz, si e përshkruani këtë rrugëtim profesional?**

- Ka qenë një rrugëtim që më ka formuar profesionalisht dhe më ka shtyrë gjithmonë drejt nivelit më të lartë. Çdo etapë ka kontribuar në ndërtimin e përvojës dhe identitetit tim si profesionist.

**Çfarë e dallon studion e re nga ajo e mëparshmeja, si në shërbime ashtu edhe në eksperiencën që u ofrohet klientëve?**

- Studioja e re sjell një standard më të avancuar, më shumë elegancë dhe një eksperiencë më të kuruar për klientin. Çdo detaj është menduar për të ofruar një shërbim më premium dhe më të personalizuar.

**Sa e rëndësishme ishte për Ju që ambienti i ri të kishte një identitet më modern dhe më luksoz?**

- Ishte shumë e rëndësishme, sepse ambienti është pjesë e identitetit të punës sonë dhe ndikon drejtpërdrejt në përjetimin e klientit.

**Si ka ndikuar besimi dhe mbështetja e klientëve në këtë zgjerim të biznesit?**

- Besimi i klientëve ka qenë themeli i çdo suksesi që kemi arritur. Pa këtë besim asnjë hap përpara nuk do të kishte të njëjtën vlerë.

**Sot je i njohur si frizer dhe makeup artist, cili ishte momenti kur e kuptove se ky profesion do të ishte rruga jote?**

- Në momentin kur e kuptova se pasioni im mund të shndërrohej në profesion dhe në një rrugë të qëndrueshme jete...

**A ka pasur sfida gjatë procesit të zgjerimit të studios dhe, nëse po, si i ke menaxhuar ato?**

- Sfida ka pasur, por përkushtimi dhe fokusi kanë qenë gjithmonë më të forta se çdo vështirësi që është paraqitur.



**Çfarë shërbimesh të reja apo risi mund të presin klientët në këtë hapësirë të re?**

- Risi moderne, më shumë komoditet dhe një koncept më premium të shërbimit, i cili synon të ngritë përvojën e klientit në një nivel më të lartë.

**Sa e rëndësishme është për ty që klientët, përveç shërbimit, të ndihen edhe komodë dhe ta përjetojnë luksin e ambientit?**

- Është shumë e rëndësishme. Klienti duhet të ndjejë kujdesin dhe nivelin e studios në çdo detaj, jo vetëm në rezultatin final, por në gjithë eksperiencën.



**Pas këtij sukcesi dhe zgjerimi në Gjakovë, cilat janë planet dhe synimet Tuaja për të ardhmen?**

- Synimi im është të vazhdoj të zgjerohem dhe të sjell gjithmonë standarde dhe risi edhe më të avancuara në fushën e bukurisë.

**Deri ku kanë arritur terminet për nuse?**

- Sivjet interesimi është jashtëzakonisht i madh dhe terminet për nuse janë rezervuar shumë herët, çka tregon besimin e madh të klientëve.

**Mesazhi Juaj?**

- Mirënjohje për çdo klient që ka besim në mua dhe në "Gjini Studio"!

Falënderoj të gjithë ata që janë bërë pjesë e këtij rrugëtimi! Suksesi im i arritur është i përbashkët me ta...

**Nderim Neziri**





## Dasmat e personazheve publike që pritet të marrin vëmendje të veçantë në vitin 2026

Viti i sivjetmë 2026 premton të jetë një vit i mbushur me dasma të bujshme në botën e shoubizit. Disa nga çiftet më të njohura tashmë kanë kurorëzuar dashurinë e tyre, ndërsa të tjerë po përgatiten për ceremonitë që pritet të tërheqin vëmendjen e publikut...



### DUA LIPA DHE CALLUM TURNER

Dua Lipa dhe Callum Turner janë ndër emrat që kanë bërë më së shumti bujë. Këngëtarja me famë botërore ka kurorëzuar dashurinë e saj me aktorin britanik, duke shënuar një nga ngjarjet më të komentuar të vitit. Pas një romance të ndjekur nga miliona fansa, çifti ka hedhur hapin e madh drejt jetës së përbashkët.

### LOREDANA DHE KARIM ADEYEMI

Edhe Loredana dhe Karim Adeyemi, gjithashtu, i kanë thënë "Po" njëri-tjetrit. Në një ceremoni intime familjare, dyshja kurorëzoi dashurinë e tyre, ndërsa pjesë e këtij momenti të veçantë ishte edhe vajza e Loredanës, Hana. Lajmi u prit me entuziazëm nga ndjekësit e tyre...





## GIMBO DHE SELIN BOLLATI

Gimbo dhe Selin Bollati pritet të jenë një nga çiftet më të përfolur të kësaj vere. Fituesja e “Big Brother VIP Albania”, Selin Bollati dhe partneri i saj kanë bërë të ditur se po planifikojnë një dasmë madhështore gjatë sezonit veror, duke rritur edhe më shumë kureshtjen e publikut...



## BORA ZEMANI DHE DONALD VESHAJ

Ndërkohë, shumë vëmendje po merr edhe çifti Bora Zemani dhe Donald Veshaj. Pas disa vjet lidhjeje dhe bashkëjetese, dyshja duket se është gati për hapin e radhës. Ende nuk dihet nëse ceremonia do të jetë private apo do të ndahet me publikun, por fansat mezi po presin detaje të reja...

## NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Nuk janë vetëm këto çifte që do e kurorëzojnë dashurinë e tyre me martesë. Ka edhe çifte të tjerë... Sidoqoftë, mbetet të shihet se cilat nga këto dasma do të kthehen në ngjarjet më të komentuar të vitit, por një gjë është më se e sigurt: sezoni i dasmave të shoubizit sapo ka nisur...

**Edona Vllasaliu – Bajoku**

# 30% OFF

## ON 3 MONTH MEMBERSHIP



**UWA**<sup>®</sup>  
SPA · POOL · FITNESS

YOUR SUMMER  
STARTS HERE



*Celebrate Love*  
UNDER PRISHTINA'S  
BLUE SKY

RESERVE YOUR DATE



# Kë e kanë gomarët babë?

*U kërkohet falje deleve të mija që nuk mund t'i kullosojmë në kodrën time, sepse ish-kryetari i komunës e ka shitur apo ia ka falur dikujt sipërfaqen e gjelbëruar të kodrës...*

Zor është sot t'i rrish përballë ndokujt kur gënjen, apo, në ndonjë mënyrë tjetër, nuk e thotë të vërtetën. Paskësh shtruar dikush një darkë në odë dhe një burrë që paskësh qenë hajn e pyet hoxhën: "Aga hoxhë, si e paguan njeriu hajninë edhe nëse nuk të kapë shteti?". Hoxha i thotë: "Nuk dihet ore burrë kush paguan, sepse mundet edhe nipi yt ta paguajë borxhin tënd nëse ke vjedhur!". Burri hajn pas darke shkon të vjedhë një kalë në një shtëpi. E zgjidh kalin, por ai i bie shqelm dhe e rrëzon në ahur. Me të dëgjuar zhurmën zgjohen burrat e shtëpisë dhe hyjnë në ahur, ku edhe e gjejnë hajnin të shtrirë. Hajni u thotë: "Ma thirrni hoxhën!". Burrat e shtëpisë e thërrasin hoxhën. Hajni i thotë: "Aga hoxhë, pse më the se për hajninë time paguajnë nipat a stërnipat?! E sheh çka më gjeti mua!". "Këtë e ke paguar për babagjyshin tënd!", ia ktheu hoxha.

## MË ËSHTË MËRZITUR POLITIKA...

Më është bërë bajat të flas a të shkruaj për politikë. Kisha dashur në këto çaste të jem bari e të ruaj bagëtinë. T'i kisha nja 100 krerë dele dhe t'i kullosoja në kodrën time.

Por, dëshirën ma prish uzurpimi i kodrës, sepse ish-kryetari i komunës njërit nga Maqedonia ia ka dhënë një truall për biznes të dhive mu te vendi i bukur, "Pishat". Më vonë ai e uzurpoi tërë kodrën me sa e sa hektarë... Nuk më ka mbetur as të kem dëshira më, them me vete. Nuk mundet njeriu me këtë pushtet as të meditojë, sepse çfarëdo vendi të bukur natyror që ka ekzistuar, është uzurpuar a shitur nga shteti dhe nuk ka mbetur vend as për meditim... "Më falni", u them deleve të paragjykuara, "kullotni ku të mundni se kodrën time e kanë uzurpuar njerëzit e shtetit!".

## OSE COFË GOMARI OSE VDES MBRETI...

Nuk po guxoj të flas tash se çka mendoj me vete për këto raste, por dua të shprehem me anë të një shembulli: Kish dal Nastradini në tregun ku shiteshin gomarët. Të gjithë e kishin çmimin nga 100 lira, pos njërit që shitej 15. "Pse ky është më i lirë?", e pyet Nastradini shitësin. "Sepse është babai i gomarëve dhe është më budallai nga të gjithë!", ia ktheu shitësi. Po në atë kohë dëgjon mbreti se në pazar shitej babai i gomarëve.

E thërret Nastradini që të mësojë më shumë për këtë rast. Nastradini i tha se babai i gomarëve, edhe pse më plakur, mund të mësojë të lexojë, madje edhe të shkruajë! Mbreti kur e dëgjoi se çka tha Nastradini, e pyeti: "Nastradin, për sa kohë e mëson ti atë gomar të lexojë?". "Për nja pesë a gjashtë vjet... Por, që ta mësoj gomarin plak të lexojë e të shkruajë më duhen para", i tha mbreti. "Nastradin, të jap para sa të duash, por nëse nuk e mëson gomarin të lexojë ta heq kokën!", ia ktheu mbreti. Nastradini i kërkoi mbretit 1000 lira që ta mësonte gomarin të lexonte brenda pesë vjetësh. Dhe, mbreti ia dha paratë. Nastradini e mori gomarin dhe paratë dhe u kthye në shtëpi. Gruaja u befusua kur i pa gjithë ato para dhe iu drejtua Nastradinit: "Ku i more gjithë këto para?!". "M'i dha mbreti, me kusht që këtë gomar, që e solla në shtëpi, ta mësojë të lexojë brenda pesë a gjashtë vjetësh", i tha ai. "Po ku mësohet gomari të lexojë, o njeri?!", ia ktheu ajo. "Brenda kësaj kohe ose cofë gomari ose vdes mbreti!", ia ktheu Nastradini.

**Selim Rama**

# MANY EXPERIENCES ONE DESTINATION

MARINA BAY — WHERE THE SEA, THE STAY & THE NIGHT COME TOGETHER.

FINE DINING · ROOFTOP NIGHTS · CASINO  
SPA & WELLNESS · BEACH · SUNSET DINING  
SEA VIEW SUITES · EXCLUSIVE EVENTS



**MARITIM**  
MARINA BAY RESORT & CASINO  
★★★★★

[www.marinabay.al](http://www.marinabay.al)

VLORË, ALBANIA

@marinabayresort\_casino

# Kohën e prishin burrat!

*Në ndeja dëgjojmë të thotë shumëkush se kanë ndërruar kohët. Ka qenë më mirë e u bë më keq... Kur e thonë këtë të vjetrit, e që kanë kaluar përvoja me Serbinë, mund të merret si konstatim me vend, por kur e dëgjon njeriu nga të rinjtë, kjo të vë në siklet!*

*Edhe këngëtarët e reja flasin në televizione, portale e gazeta dhe ankojnë se mbaruan me punë e angazhime... Çudi, a?!*

Më tha një ditë një mik imi se, sipas tij, kisha humbur prej kohësh.  
"Mik, kohë nuk po kam!", i thashë.  
"Dashtë Zoti të kesh para bile, me punën që bën!", ma ktheu ai.  
"Më shumë jam në zor për kohë se për para, se para kam e koha nuk po më del të takohem me askënd!", ia ktheva.  
A thua, kush i ndërron kohët?  
Disa thonë vetë koha, disa politika e disa...  
Për të dëshmuar se politikanët e ndërrojnë kohën, një rrugë në Prishtinë, të "Sahat Kulla", ka pasur disa emra, varësisht nga situata dhe ndërrimet politike...  
Rruga që tash quhet "Ali Hadri" dikur quhej "Boro Vukmiroviq", më vonë "Zef Lush Marku", pastaj "Boro Kozarac"!  
Pra, sa e sa kartolina duhet të rishikoheshin për ta kuptuar historikun e ndërrimit të kohëve...  
Sa e sa letra mbajnë të dhëna e histori nga koha kur ishte primare të shkruhej bukur dhe pa gabime.  
Sa e sa...

## HISTORI KA LËNË EDHE NASTRADIN HOXHA...

Nastradini punonte në arë.  
Fqinji i thotë: "Nastradin, të gjithë i mashtron, por mua kurrë!"  
"Lëri fjalët, por tash na vjen dreka e pastaj flasim", ia kthen Nastradini.  
Nastadini e kishte lidhur lepurin për qerren që e kishte në ara, e zgjidhi dhe e mori në dorë.  
I tha lepurit: "Shko dhe thuajti zonjës së shtëpisë le të sjell lepur të pjekur, kajmak dhe shurup!"  
Ndërkohë e lëshon lepurin të vrapojë...  
Dhe, nuk vonoi e gruaja ia solli në arë të gjitha që ishin marrë vesh t'i vinin për drekë...  
Fqinji e luti Nastradinin t'ia shiste lepurin, se qenka i mençur.  
E mori fqinji lepurin, pastaj shkoi në qytet dhe bleu mushkëri. Më pas doli në gjah e i tha lepurit: "Merri këto mushkëri dhe qoja gruas dhe thuaj t'i përgatis për drekë!"

E lëshoi lepurin dhe priste gruaja t'ia sillte drekën në mal, ku edhe ndodhej për gjah. Por, kot...

Kur shkoi në shtëpi e qortoi gruan.

"Pse nuk m'ï solle mushkëritë?!", i tha.

"Cilat mushkëri?! Qenke çmendur, ore!"

Burri e kuptoi hilen e Nastradini dhe i va-  
jti në shtëpi. Me të hapur derën Nastradini  
e kishte kapur gruan për flokësh dhe ia  
kishte vënë thikën në fyt.

E kishin kurdisur situatën ashtu që burri  
që erdhi, duke parë se Nastradini ishte  
çmendur, as që pat kohë ta përmendte  
lepurin...

Nastradini e gërvishti pak gruan dhe asaj  
i doli gjaku. Ajo u bë sikur do vdes. Në

atë moment Nastradini mori fyellin dhe  
nisi t'ï bjerë, kurse pas pak gruaja nisi të  
lëvizë. Nastradini i tha burrit se fyelli është  
magjik dhe e ngjallë gruan.

"A ma shet, pra, fyellin, o Nastradin, se  
gruaja më çmendit!", i tha fqinji.

Nastradini ia shiti fyellin.

Burri me të ardhur në shtëpi u grindë me  
grua dhe ia preu kokën. E mori fyellin ta  
rikthejë në jetë.

Kur pa se nuk ishte punë ringjalljeje, i tha  
vetes: "Meqë nuk po ringjallet menjëherë,  
po ia lë kohës".

Pas do ditësh takon Nastradinin dhe i  
thotë:

"E di hilen tënde, por ia kam lënë kohës!".

"Mirë ke bërë!", ia ktheu ai.

## HOXHA DHE PËRSHESHI

Por, edhe koha e ka një kohë...

Një fshatar kishte shkuar te hoxha për të  
kërkuar një sqarim.

Hyn brenda në faltoren e tij dhe ulet.

Hoxha në ato çaste po hante përslesh.

"Fol se po të dëgjoj", i thotë dhe nuk e  
ndalte dot përseshin...

Fshatari nisi t'ï tregonte për hallin që  
kishte:

"Hoxhë efendi, sapo e kam korrë grurin  
dhe për sivjet kam bukë për nja nëntë  
muaj. Dua t'më këshillosh se ku ta marr  
bukën edhe për tre muaj të tjerë?"

N'çast, hoxha nisi t'ï shpejtonte lugët, zu  
të hante më shpejt...

"Fol ti, fol...", i tha hoxha fshatarit dhe e  
mbushte lugën sa mundte me përslesh...

Dhe, kur e hëngri përseshin, hoxha i tha:

"Eh, more jaran, unë ngutesha që ta haja  
sa më shpejt përseshin, se frikësohesha  
mos ma merr Zoti shpirtin e më mbetët  
përseshi pa e hëngër, kurse ti mendon se  
çka do të ndodhë pas një viti!"

Atëherë, fshatari ngrihet në këmbë dhe i  
thotë:

"Ditën e mirë, hoxhë efendi!"

"Rri, ku shkon, o burrë?", i tha hoxha.

"Çka të flas tjetër kur ti nuk i beson as  
dakikut?!"

**B. Bajrami**



# Babë e bir urrejnë njëri-tjetrin!

Fqinji im punonte në kopsht.

"Çka do të mbjellësh këtu, se e paske  
lëruar mirë tokën?", i thashë.

"Dua të mbjell disa fidanë. Kanë për  
t'u rritur sa plepat, sepse në fshatin  
tonë është toka për pemë. Dhe, këtë  
punë po e bëj për inati të djalit!"

Eu, thashë vetë me vete, paska edhe  
kështu, a?!

Por, ka edhe më keq...

Tezaku im me djalin e tij janë inatxhi

të fortë mes vete. Më inatxhi se LDK-  
ja e "Vetëvendosja".

Nuk flasin me vjet mes vete.

Jetojnë si armiq, flasin si armiq, e  
janë babë e bir! Njëri-tjetrin e thërra-  
sin në emër.

Kur hyn në shitoren e fshatit tonë,  
tezaku im kënaqësinë më të madhe  
e ka kur flet keq për të birin e tij...

Pra, keq e më keq!

**T.**



## Nëma më e keqe: **Mbetsh vejushë!**

*“Në qoftë se ekziston femër në botë të ketë vuajtur shpirtërisht si unë, atëherë ajo do të ketë përfunduar në humnerë të pafund”, thotë Sadberja, 54 vjeçe, nga Suhareka.*

### SI E LËSHOVA UDHËN E ZOTIT?

“Ishte hera e parë që në vitin e fundit të shkollës së mesme po më rrokno do farë dridhjes të çuditshme, e që nuk më kishin goditur asnjëherë tjetër. I thosha vetes se isha ende e re, për të mos thënë fare e pamësuar dhe tej mase e frikësuar të nisja dashuriçkat e moshës që i takoja, edhe pse shoqet e mia nuk e qanin kokën për gjëra të tilla. Dhe, në këtë kohë, fillova të dal pak nga ajo “udha e Zotit”... Këtë devijim timin lozonjar e vërejtën menjëherë vëllezërit e mi, të cilët më ndaluan të dilja nga shtëpia pa i pyetur paraprakisht se kah do ta thyeja qafen. Për këtë arsye edhe humba besimin e tyre për të vazhduar shkollimin më tutje, pra studimet në Prizren, e që ishte një goditje e rëndë për mua dhe e para në jetën time.

### SHOQET E MIA DASHUROHESHIN, E UNË?

Dhe, deri në moshën 21 vjeçe jeta ime ishte e njëjtë: e zymtë dhe krejtësisht monotone, edhe pse kohëve të fundit kisha dal nga pak nga shtëpia, por nuk kisha njohur askënd. Në anën tjetër, të gjitha shoqet e mia kishin gjetur të dashurit e tyre, madje ishin

dashuruar edhe nga dy a tri herë... Pas një kohe njëra nga motrat e martuara më propozoi fejesë me një djalë që bashkëshorti i saj e kishte të afërm. Por, dola me të dhe nuk më pëlqeu... Po atë verë, për çudi, pa menduar gjatë, u fejova me një shok të vëllait tim të dytë, i cili ishte djalë me fakultet të kryer dhe pasuri të madhe në një fshat të komunës së Rahovecit, të cilit nuk dua t’ia përmend emrin, sepse tash më neverit. Për çudi, më pëlqeu që në takimin e parë. I tregova se nuk kam pasur lidhje me askënd, andaj të flinte rahat. Dasma u bë një të diel me shi, erë dhe bubullimë. Dhe, pika e vlimit tim ndodhi pas dy javësh, kur më thanë të shkoja në ahur dhe t’i milja lopët. Kundërshtova para të gjithëve dhe në atë moment burri im u ngrit në këmbë dhe më ra shuplakë. Më pas grushtimet e tij pasuan edhe në dhomën e fjetjes. Dhe, që nga ajo ditë, edhe pse bëra jetë me të një vit, mezi prisja të gjeja rastin t’i jepja fund martesës dhe të mos rrija asnjë ditë në atë shtëpi...

### JETA SI VEJUSHË

Jeta si vejushë ishte edhe më e rëndë se ajo kur rrija e mbyllur para martesë në shtëpi. Tashmë nuk më pengonte askush të dilja, por sa herë që dilja në rrugë më bëhej se të tjerët flisnin vetëm për mua.

Nuk më pengonte kush të dilja, por nuk e kisha freskinë e dikurshme. E ndjeja mungesën e një mashkulli, sepse veç isha mësuar të flija me dikë. Dhe, sa herë që dilja në qytet, veç sa dëshpëroheshja, sepse shumëkush mendohej të më shtinte në dorë, qoftë edhe për një natë. Në pranverën e vitit tjetër u njoha me një burrë që i kishte 33 vjet, me të cilin ramë dakord të martoheshim, meqë edhe ai kishte qenë i martuar një herë. Me t’u martuar për së dyti, u dhashë shqelm gjithë atyre meshkujve që më ndiqnin pas sa herë që dilja jashtë shtëpisë. Tim burrë në fillim fillova ta doja, por shumë shpejt filloi t’me dilte nga zemra. Më shkonte në nerva për shumëçka. I thashë se jam e sëmur dhe nuk dëshiroja të nissha kurrfarë fëmije, të cilin ai e dëshironte shumë. Ky edhe ishte shkaku i një zënke shumë të ashpër, e cila edhe përfundoi me ndarje. Dhe, që nga ajo kohë, edhe pse kanë kaluar vite e vite, më nuk kam besim në askënd dhe si vejushë më shumë rri mbyllur sesa që dal nga shtëpia, sepse e kam emrin e keq: të gjithë më thërrasin vejushë. Andaj, nëse do me e nëmë dikë për të keq thuaj: Mbetsh vejushë!

**Diturie Haxhaj**



## Dizajnerja e modës **Liridona Hajdari** sjell elegancë moderne në tregun vendor

*Liridona Hajdari po konsolidon gjithnjë e më shumë praninë e saj në industrinë e modës, duke ofruar dizajne të veçanta që ndërthurin thjeshtësinë me elegancën moderne. E fokusuar kryesisht në krijimin e fustaneve solemne, marka e saj synon të theksojë finesën dhe individualitetin e çdo klienteje.*

E themeluar në vitin 2022, veprimtaria e saj është zhvilluar mbi një qasje të personalizuar ndaj modës, ku çdo detaj merr rëndësi të veçantë. Një nga karakteristikat kryesore të këtij biznesi është fakti se i gjithë procesi krijues, nga stili deri te qepja, realizohet nga vetë dizajnerja, duke garantuar kështu cilësi dhe identitet unik në çdo produkt.

Përveç koleksioneve të gatshme, Hajdari ofron edhe shërbime me porosi, duke i përshtatur dizajnet sipas kërkesave dhe dëshirave specifike të klientëve. Kjo fleksibilitet ka ndikuar në rritjen e interesit për krijimet e saj, sidomos në mesin e

atyre që kërkojnë veshje unike për raste të veçanta.

Sa i përket trendeve më të kërkuara, klientët po orientohen drejt modeleve me dizajn unik, të karakterizuara nga draping-u dhe stili klasik, ndërkohë që mbetet i lartë edhe interesi për fustane të dekoruara me gurë, të cilat shtojnë një prekje luksi dhe shkëlqimi.

Të interesuarit mund ta gjejnë dizajneren në Prishtinë, në rrugën C, si dhe në platformën Instagram përmes profilin "liridonahajdariofficial", ku prezantohen krijimet më të fundit dhe projektet në zhvillim.



## ***Politika më ndau nga i dashuri!***

*Deri para më pak se një vit isha në lidhje dashurie me një djalë që e doja shumë, ama shumë... E, edhe ai më donte...*

*Por, si duket, fati ishte i tillë që ne të mos jemi gjithmonë bashkë...*



Ulqini m'i lëvizi "fluturat" në bark!  
Çdo gjë filloi në Ulqin.  
Vend i mrekullueshëm se jo mahi...  
Në Plazhin e Madh kishte edhe njerëz të tjerë, kryesisht të rinj.  
Laheshin, qeshnin dhe flisnin me zë të lartë.  
Më bezdisi ky fakt dhe mundohesha të mos i dëgjoja se ç'flisnin...  
Ua ktheva shpinën dhe bëhesha sikur rrezitesha.  
Pas pak çohem për t'u larë dhe shoh se pas meje vjen një nga djemtë që laheshin më parë në det.  
Pas një noti të mirë bie mbi zall që të rrezitëm.  
Ai ishte shtrirë afër meje dhe më shikonte...  
Dikur u afrova edhe më afër dhe më tha: "Hyrë edhe një herë në ujë se dua të të them diçka".  
Nuk i thashë gjë, por vetëm qesha me ironi...  
Ai u ngrit, hyri në ujë dhe priste që të shkoja pas tij...  
Por, kur pa se nuk shkova, doli nga uji dhe

erdhi përsëri afër meje dhe u shtri mbi rërë...  
E solla në mendje: të çuditshëm janë djemtë - të ngacmojnë edhe pa të njohur, edhe pa ditur a ke ti të dashur a jo...  
Edhe të nesërmen veproji njëjtë, si një ditë më parë. Madje, këtë ditë edhe më pyeti si qushesha. Por, nuk i tregova...  
Dhe, nuk di as vetë nga e kishte mësuar, por më tha se ma di emrin...  
Mbetë e habitur kur tha emrin tim...  
Pas dite më erdhi një sms dhe një foto imja, duke u rrezitur në plazh...  
Oh, s'e keni idenë si më lëvizën "fluturat" në bark... E lexova dhe nuk i ktheva përgjigje.  
Pas nja dy orësh më erdhi një sms tjetër, ku më thoshte: "Ti do bëhesh e imja".  
Dhe, ndodhi si ndodhi, unë me familjen time pas tri ditësh përfundua pushimin në Ulqin.  
Pas disa ditësh i shkrova një sms. "Të lutem, prej nga je?", e pyeta.  
"Jam nga Prishtina", ma ktheu.  
Dhe, që të bindem se ai, vërtet, ishte nga Prishtina, e që mua më shkonte shumë për shtati, e lus të më thërriste në telefon nga

një numër fiks.  
Nuk kaluan as pesë minuta dhe nga një numër fiks nga Prishtina dëgjova zërin e tij.  
Ishte po i njëjti zë që e kisha dëgjuar edhe në plazh, në kohën kur më pyeste si e kam emrin dhe që të hynim në ujë bashkë...  
Dhe, nga dita tjetër nisa të dalë me të kudo: në kafene, në shesh, në park...  
Kështu, me kohë dashuria jonë nisi të lulëzojë dhe mburresha me fatin që ma ofroi Zoti...  
Por, pas një viti bashkë, në një moment, u zumë keq, thuajse për hiçgjë, e që nuk ia vlente...  
"Mollë sherri" u bë politika, sepse ai ishte një adhurues i madh i partisë në pushtet. Tërë kohën nisi të fliste për politikë, për zgjedhje të reja, e çka jo tjetër...  
E, unë, meqë jam bijë e një aktivisti që ka bërë shumë për kombin, nuk ma lejonte ndërgjegjja të isha në vijë me të!  
Dhe, ndodhi si ndodhi më nuk jemi bashkë...  
U shua një dashuri e madhe për hiçgjë!

**Vitorja, Prishtinë**

12 - 15 QERSHOR

Cakto konsulten tende

# Dr. Johann Nemrava

Specialist i Kirurgjise Estetike dhe Plastike

+383 45 707 744



# 5 vjet jetë me një puthje!

*Kur i mbusha 20 vjet, sa rritesha aq edhe zbukurohesha. Ma kishin lakmi shoqet e mia për bukurinë që kisha, por edhe për sjelljet e mia korrekte me djem. Kur dikush më propozonte të dilja me dikë, së pari, ua kërkoja fotografinë që ta shihja se si dukej, e pastaj vendosja a të dilja për një kafe a jo... Një ditë, një shoqe imja, Jeta, ma ofroi një foto në të cilën dukej një djalosh zeshkan, e që në shikim të parë nuk më pëlqeu hiq. Por, me kohë gjërat ndryshuan...*

Kur ime shoqe Jeta, ma propozoi një dajë të vetin që të njihesha me mua, në fakt, si thashë jo, por pranova ta shikoja foton e tij njëherë.

Në foto, thënë të drejtën, s'më pëlqeu fare...

Sipas saj, ai ishte dhënë shumë pas meje... Por, nejtë, kështu filloi krimbi.

Thashë: "Mirë, të njihemi!"

Nuk ishte një takim si të tjerët kur njihen dy të rinj ndërmjet veti. U bë nëpërmjet telefonit me sms. Ai më shkroi i pari dhe unë ia ktheva mesazhin. Të nesërmen e lamë të takoheshim në qendër të Rahovecit, meqë në Xërxë më njihnin pothuajse të gjithë...

E mbaj mend edhe sot atë ditë.

Sa emociione kisha...

Por, mundohesha të përmbahesha.

Gjatë takimit, për çudi, më tërhoqi pjekuria, zgjuarsia edhe ngrohtësia e tij... Më dukej sikur njihesha prej kohësh.

Kemi qëndruar dy orë bashkë atë ditë, e mua m'u dukën si 10 minuta...

Dikur kërkova leje prej tij dhe u largova,

sepse nuk doja ta kuptonte se më pëlqeu që në takim ta parë.

## KAFE E LLAFE 3 MUAJ RRESHT...

Ditët në vijim ishin të ngarkuara për mua: flisnim me orë të tëra në telefon, i shkruanim njëri-tjetrit sms pa reshtur...

E, kjo zgjati rrafsh tre muaj: takime, kafe e llafe... Kështu, ai u bë njeriu më i rëndësishëm për mua...

Por, pas tre muajsh disa ditë nuk u paraqit fare.

"A thua, çka i ka ndodhur?", e solla në mendje. Fillova të mërzitesha.

Kah mbrëmja më erdhi një sms nga ai. Kërkonte të takoheshim nesër paradite dhe asgjë më shumë.

Të nesërmen, kur u takuam, në sytë e tij pash një zhgënjim. Dëshiroja ta puthja, por më mungonte guximi.

Filluam të bisedonim. Më tha se më nuk mund të takoheshim...

"Pse?", i thashë.

"Nuk mund të jem i yti përgjithmonë!", ma

ktheu.

"Po, a?!", ia ktheva.

"Po, sepse unë që moti jam i fejuar!", foli me gjysmë zëri.

## DOJA TA HAJA TË GJALLË!

Në çast ia hodha një shikim të rreptë.

Seç më lindi një urrejtje aty për aty.

Doja ta kapja për flokësh dhe ta shkunjta si batanijen kur e shkundim në ballkon.

Pasi u qetësova pak shkuam në kafenenë ku rrinim gjithnjë dhe biseduam gjerë e gjatë.

Por, bandilli tashmë e kishte marr vendimin.

Më shtrëngoi fort e fort për trupi dhe ma dha puthjen e parë, por edhe të fundit...

Kësaj vere bëhen 5 vjet nga ajo puthje, e që mua nuk më hiqet dot nga mendja... Pse?

Ishte puthje magjike, a?!


Sidoqoftë, para meje qëndron dilema: Si do gjej forcë t'i hidhem në krahë një tjetri?

**Vegimja, Xërxë**

# KENDA

CENTER

Trupi juaj e meriton këtë  
**AJENI GATI?**



**Rezervoni seancën tuaj të parë sot! +**

**DM ose na telefononi**



# ATY KU U TAKUAM - ATY EDHE U NDAMË!

*Kur më the: “Nesër eja te vendi ku jemi takuar për herë të parë”, atë ditë dita kaloi si me dhunë.*

*Natën nuk më zuri gjumi, kurse kur erdh mëngjesi, me zemrën që më rrihte pa masë, u nisa dhe m'u bë sikur udhëtova një shekull rrugë derisa u gjeta përball teje e syve tu...*

Eh, sa kohë ka kaluar pa u takuar më!  
Dhe, pas krejt asaj kohe sot të mbaj dhe një herë në përfaqimin tim, teksa biseduam për shumëçka: për dëshirat tona që tash kanë mbetur veç ëndrra.  
Po në këtë vend dikur jemi takuar dhe i kemi thënë njëri-tjetrit se vetëm vdekja

mund të na ndajë.

Këtu jemi betuar se kemi me luftuar për dashurinë tonë, pavarësisht vështirësive që mund të paraqiten.

Në këtë vend jemi takuar herën e parë dhe shumë herë të tjera.

Po në këtë vend ka qenë edhe takimi i fundit...

## QANTE EDHE DIELLI NË NDARJEN TONË!

Eh, qe edhe një herë u takuam në atë vend, por këtë herë më ndryshe se herëve të tjera.

Lotët tanë i paraprijnë ndarjes, trishtimit që na ka kapluar. Nisa të mallkoj fatin. Ai ishte i pamëshirshëm dhe i çuditshëm.

Kishte vendosur ndarjen tonë.

Në ato çaste kërkoja që të përqaftuar të ngrihem i përtej kufijve të mundësisë sonë,

të shkojmë në amshim...

A thua, a e kanë dëgjuar dhe ndjerë atë ditë ndarjen tonë Zoti, dielli dhe engjëjt?  
Edhe ata do të kenë qarë!

Edhe ti e edhe unë e dimë se Zoti kishte dashur të takohemi edhe një herë, që ta kuptojmë se sa shumë jemi dashuruar, edhe pse që të dy e dinim se ai nuk ishte tjetër veç takimi i ndarjes te bliri i kujti-meve tona...

## ATY KU U TAKUAM - ATY EDHE U NDAMË

Te bliri jemi takuar shumë herë dhe vetëm ai vend e di sa shumë jemi dashur unë e ti dhe po në atë vend edhe u ndamë për përgjithmonë, duke i premtuar njëri-tjetrit se kurrë nuk do të lejojmë që dashuria të zbehet, ani pse nuk do jemi bashkë kurrë...

**S. M.**



Lidhjet e plasaritura...

# A tradhtojnë të gjitha femrat?

*Pse ju shkel ajo juve?*

*Tradhtia në marrëdhënie është gjëja më e dhimbshme që mund t'i shkaktojë dikush personit me të cilin është në lidhje. Jo vetëm që u dëmton egon, por mund t'i bëjë edhe të pasigurt në veten e tyre...*

Edhe pse dashuria dhe kënaqësia në një marrëdhënie nuk janë attribute të caktuara, megjithatë zakonisht tradhtia rezulton nga një pakënaqësi. Nuk ka justifikime për tradhti, edhe pse shumica e meshkujve thonë se "ne kemi gjene poligame", gjë që në ditët e sotme vërehet edhe te femrat.

Ndoshta kështu mendoni edhe ju.

Nëse ju nuk dëshironi të jeni "i tradhtuari", atëherë kushtojuni rëndësi këtyre gjërave:

\* Kushtoji rëndësi detajeve, në veçanti pamjes së saj. Mos harro komplimentet, bëhu pak romantik.

\* Kur është fjala për seks, mos i bë gjërat rutinore, bëj diçka ndryshe, të veçantë, të mrekullueshme dhe mahnitëse.

\* Bëhu i ndershëm, i sinqertë, komunikues dhe i vëmendshëm kur ajo bisedon me ju.

\* Nëse në fillim ishe i mirë, vazhdo të mbetesh i tillë, mos u bë dembel dhe i pa interesuar për gjërat e përbashkëta.

\* Ji i pranishëm dhe i përkushtuar, fito besimin e saj.

## NUK JANË TË GJITHA FEMRAT TRADHTARE...

Ekzistojnë disa femra që mendojnë se "të gjithë meshkujt janë të këqij", por ka të tjera që mendojnë ndryshe dhe janë të gatshme për një lidhje të mirë.

Të tilla mund të takosh kudo.

Nëse keni takuar njëren nga ato që ia vlen ta keni në krahë, mos hezito.

Pa dyshim, ka të tillë që tradhtojnë njëri - tjetrin, por nëse ju dëshironi të keni një marrëdhënie monogame dhe të begatë, atëherë bëni çmos të mbani lidhjen tuaj të "pastër" dhe të mrekullueshme, sepse nuk janë të gjitha feramat tradhtare, ka edhe të tilla që nuk luhaten në lidhjen e tyre.

Nga një kënd ndryshe

# Pse e kemi në shpirt inatin?!

*Çka do që bëjmë ne, shqiptarët, e bëjmë për inati, e jo për interes personal, familjar a kombëtar. Edhe kur udhëtojmë diku e bëjmë për inati të dikujt tjetër!*

*Në fakt, punët nuk ndryshojnë kurrë, sepse nuk jemi rastësisht kështu e këtu ku jemi...*



Ashtu sikur punojmë edhe i kemi punët. Tamam na vjen një gëzim që e kemi shtetin tonë dhe Serbia më nuk na rri me polici mbi kokë, posa të zgjohemi në mëngjes gëzimin na e varrosë gjendja politike: moszgjdhja e presidentit, pa Kuvend, pa qeveri stabile, e çka jo tjetër...

Pse tamam nis diçka – ndalet?! Se është kështu po e ilustruj me një shembull:

Po ecte një burrë me një thes me grurë në shpinë. Gjysmën e thesit e mbante në qafë e gjysmën në krah. E qonte në mulli ta bluante.

Teksa ecte, një burrë e pyet:

“Si je jaran, si po kalon?”

“Mirë jam, por jam lodhur me këtë jetë!”, ia kthen ai.

“E tillë është jeta, duhet durim! Ç’ti bësh?!”, i thotë ai.

“Vafsh në djall edhe ti me gjithë këtë muhabet! A po e sheh ç’kam në qafë?!”, ia kthen.

Andaj, edhe ne, shqiptarët e Kosovës, jemi bërë si burri me thes në shpinë...

Jemi lodhur më...

## **E HABITSHME: ASGJË NUK LEXOJNË - TË GJITHË TË “DIJSHËM”!**

Zgjohem në mëngjes, pi kafe në njërin nga lokalet afër Redaksisë.

Në biseda të ndryshme, edhe pse pak-kush lexon, të gjithë dinë për politikë! Të gjithë të mençur!

Nisin t’i komentojnë debatet në studiot e televizioneve tona që i fryjnë zjarrit dhe njëri nga ta, teksa pimë kafe, thotë:

“Filan moderatori, që udhëheq debate televizive, është “shtic”, sepse i hasmëron analistët ndërmjet veti!”. Andaj, kur njeriu mendon paksa më thellë, pashmangshëm i thotë vetes: Nuk jemi rastësisht kështu e këtu ku jemi, por tërë kjo është produkt i punës sonë për vetveten. I kemi punët kështu si jemi vetë...

## **NË AMERIKË PËR INATI TË ISH-TË FEJUARIT!**

Po e jap në vazhdim një muhabet që e dëgjova teksa pija kafe në parkun e qytetit, teksa i tregonte një femër një femre tjetër, e që, me gjasë, e kishte prishur fejesën:

“Jam kah foli me një njeri në Amerikë. Jo që kam qejf me shkua atje, por do shkoj në Amerikë veç për inati të këtij që më la, sepse ma bëke “ty nuk të merr askush!”.

Dhe, nuk ka muhabet as bisedë ku nuk ceket inati. Askush nuk thotë se po e bën për interesin e vet, të kombit, e çka jo tjetër...

Kur e patën pyetur një burrë të komunes së Lipjanit pse i ke bërë 26 fëmijë, ai tha: “I bëra për inati të një burri nga Bardhoshi, se ai ka pasur më shumë se unë!”.

## **ÇDO GJË PËR INATI TË TJETRIT...**

Kishin qenë ty vëllezër dhe kur zgjoheshin në mëngjes uleshin pranë oxhakut.

Instinktivisht i madhi luante me hirin e oxhakut.

E rrafshonte hirin me shuplakën e dorës.

Pasi e rrafshonte merrte një krande dhe bënte vija. Vëllai i vogël ofron kokën të shihte çka bënte më i vjetri dhe e pyet:

“Çka po bën?”.

“Po e bëj planin e shtëpisë që do e ndërtojmë”.

“Jo tybe, s’kemi me e bë kështu kurrë, por qysh them unë!”

Dhe, e rrafshonte hirin me shuplakë dore dhe fillonte të bënte vija...

“Ti nuk ke lidhje me shtëpi, prandaj kështu nuk mund ta bësh kurrë!”, ia kthente i madhi.

Kështu, fjalë pas fjale e qonin ditën, e në mbrëmje i thonë njëri-tjetrit: “Të flemë se për sot boll punuam...”

**S. Rama**



**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE


**Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI**




  @dentfix ks  
**+383 44 22 55 34**  
[www.dentfix-ks.com](http://www.dentfix-ks.com)  
Ahmet Krasniqi Str. No 137,  
Pristina, Kosovo



Part of DENTFIX GROUP



**CARE & HAIR FIX**  
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC



  
**CARE & HAIR FIX**  
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC